

Rafet Rudi / Donika Rudi Berishaj

Edukatë muzikore

6

Libri i Mësimdhënësit/es

Të nderuar kolegë,

Libri që po e merrni në dorë ju është dedikuar juve, me të vetmin qëllim që puna juaj të bëhet më e lehtë, më e natyrshme dhe kjo punë të japë rezultate maksimale në transmetimin e njohurive të domosdoshme që nxënësit ta formojnë personalitetin e tyre intelektual dhe emocional, me shpresë që ata, gjithashtu, të kultivojnë qëndrim aktiv ndaj vlerave të kulturës së ngushtë kombëtare, por edhe të vlerave gjithënjëzore.

Libri respekton strukturën formale të temave, të cilat janë përfshirë në kurrikulën e lëndës së muzikës. Dhe, siç parashihet në të, rezultatet e të nxënit të fushës (RNL), të cilat zbërthehen dhe specifikohen me anë të rezultateve të të nxënit të lëndës, të organizuara në katër tërësi tematike kryesore: Krijimtaria dhe performanca artistike, Gjuha dhe komunikimi artistik, Muzika dhe shoqëria dhe Çmuarja dhe vlerësimi estetik-artistik.

Brenda për brenda këtyre temave, këshillat jepen në radhë të parë që arsimtari të ketë informacion më të kompletuar sesa që libri i nxënësit përmban.

Kujdes i veçantë i është kushtuar ndërlidhjes së muzikës me lëndët e tjera. Kjo është bërë në hapësirën e dëgjimit muzikor, të mësimin të këngëve, të njohjes së instrumenteve etj.

Mbi të gjitha, ky libër do ta ndihmojë arsimtarin të gjejë një rrugë të përshtatshme që të arrijë në cakun përfundimtar, e ai është: a) aftësimi i nxënësit për ta përjetuar muzikën si dëgjues aktiv dhe si pjesëmarrës i drejtpërdrejtë b) që nxënësi ta kultivojë ndjenjën dhe shijen për të dalluar vlerën dhe jovlerën në muzikë c) të kontribuojë në zhvillimin e aftësive për punë të pavarur dhe d) që nxënësi të jetë gjithmonë pjesëmarrës sa më aktiv në botën e muzikës. Kjo qasje e përgjithshme në procesin e edukimit dhe arsimimit muzikor pa mëdyshje do të ndikojë në formimin e ndjenjave estetike, patriotike dhe sociale të tij.

Autorët

Hyrje në botën e muzikës

Muzika

Funksion themelor i muzikës, si edhe i të gjitha arteve, është fisnikërimi i njeriut. Muzika është shtylla më e rëndësishme e edukimit dhe zhvillimit estetik të njeriut. Pikërisht për këtë arsye, edukim dhe arsimimi estetik përmes lëndës së muzikës zë vend të rëndësishëm në procesin e gjithmbarshëm të shkollës sonë.


Muzika nxit përjetime estetike, duke kontribuar në ngritjen intelektuale të fëmijës dhe në formimin e personalitetit të tij. Ndikon në formimin e ndjenjës morale dhe të ndjenjës për atdhedashuri. Meqë arsimimi muzikor e nënkupton punën grupore, ajo në mënyrë direkte ndikon në socializimin e tij, komponent i rëndësishëm në formimin e përgjithshëm shoqëror të fëmijës. Arsimimi muzikor ka për detyrë të nxisë fëmijën që muzikën ta dëgjojë, ta interpretojë e ta përjetojë, me çka ajo ndikon në zhvillimin e botës emocionale të tij.

Qëllimet e lëndës Edukata muzikore

Qëllimi kryesor i lëndës Edukata muzikore është kultivimi i dëshirës së fëmijës që të jetë pjesë e botës së muzikës si pjesëmarrës aktiv: në njohjen e saj, në njohjen e bukurive të saj, në njohjen e rrugës që çon drejt saj. Kusht themelor për të hyrë në këtë botë është dashuria ndaj saj, andaj detyra tjetër themelore e edukimit muzikor qëndron pikërisht në përpjekjet e saj që të zhvillojë dashurinë të nxënësit për muzikën.

Kjo lëndë synon që këtë lidhje të nxënësit me muzikën ta bëjë: përmes këndimit të këngëve që figurojnë në libër, dëgjimit të muzikës, luajtjes në instrumente, nxitjes për krijimtari muzikore, zhvillimit të kreativitetit muzikor, improvizimit, zhvillimit të mëtutjeshëm në njohjen e elementeve dhe koncepteve të reja muzikore etj.

Nxënësi duhet të aftësohet për ta përjetuar muzikën si dëgjues aktiv; ta kultivojë ndjenjën dhe shijen për të dalluar vlerën dhe jovlerën në muzikë, por ai duhet të aftësohet që të jetë pjesëmarrës aktiv, duke u shprehur përmes saj. Kjo qasje e përgjithshme në procesin e edukimit dhe arsimimit muzikor, pa mëdyshje ndikon në formimin e ndjenjave estetike, patriotike dhe sociale.



Performanca dhe krijimtaria artistike: **Udhëtimi në botën e muzikës**
Këndojmë /Interpretojmë/ Krijojmë

a) Këngët

Është e mirëditur se kënga është forma më e përshtatshme në kultivimin e lidhjes së nxënësit me botën e muzikës, andaj me arsye kënga zë vend të rëndësishëm në procesin arsimor-edukativ. Ajo zhvillon ndjenjat estetike. Kënga ndikon në zhvillimin e muzikalitetit të fëmijës, veshit të tij muzikor, zhvillimit të mundësive vokale të nxënësit, kultivimit të këndimit të bukur dhe ndikim qenësor në zhvillimin e përgjithshëm muzikor. Përmes këngës zhvillohet ndjenja për ritëm dhe ndjenja për intonim të saktë, memoria muzikore, aftësia motorike. Gjithashtu, përmes këngës nxënësi njihet me konceptet e para nga fusha e teorisë së muzikës.

Meqë kënga është e lidhur me fjalën artistike (me poezinë), ajo bëhet akoma më e aftë që të transmetojë emocione të fuqishme, me çka pasuron botën emocionale të nxënësit. Përmes saj kultivohet dashuria për atdheun, dashuria për natyrën, dashuria për vendin dhe rrethin ku jeton. Së këndejmi, me këngën, në mënyrë të përshtatshme dhe efikase, zhvillohet kodeksi moral dhe shoqëror i nxënësit.

b) Interpretimi në instrument

- ***Instrumentet ritmike***
- ***Instrumentet melodike***

Që nga klasat e ulëta, te nxënësit ekziston përvoja e shoqërimit të këngës me instrumente ritmike (shkopinj, me gurë, me lugë apo duke i përdorur pjesët e trupit, rrahje të shuplakave etj.). Gjithashtu ekziston përvoja me përdorimin e instrumenteve të thjeshta të ORF-it. Ndërkaq, luajtja në instrumentet melodike ka qenë më pak e shprehur.

Në fazën e re të arsimit dhe edukimit muzikor, me zgjerimin e njohurive teorike dhe sidomos me aftësimin e tij që këngët t'i mësojë sipas tekstit notal, te nxënësi rriten mundësitë që ai ta praktikojë luajtjen me kompetencë më të madhe, sikur instrumentet ritmike, ashtu edhe ato melodike.

Arsimtari duhet të ketë kujdes të posaçëm që të përfshijë në këtë aktivitet, në radhë të parë, nxënësit që mund të jenë më pak aktivë në këndim, për arsye se kanë pengesa në këndim apo ata nxënës, të cilët nuk shquhen për zë të mirë. Nxënësit duhet ta ndjejnë kënaqësinë e luajtjes në instrumente.

Është listë e gjatë e **instrumenteve ritmike** që nxënësit mund t'i përdorin në këtë nivel të arsimimit/zhvillimit. Janë këto kryesisht instrumentet e ORF-it: triangëli, defi, marakasi, shtambushka, gërreza, me të cilat lehtë mund të improvizohet.

Përpos këtyre instrumenteve, arsimtari mund të fusë në përdorim edhe instrumentet popullore, si: raketakja, gurët, cinglat (shkopinjët), rrëkezat, lugët, këmborët, tingëzat, lodra etj.

Instrumentet melodike që konsiderohen më të përshtatshme për nxënësit fillestarë janë: blokflauti (fyelli), glockenspili (zilet), melodika, ksilofoni etj.

c) Kreativiteti muzikor

- Veprimtaria krijuese e nxënësit duhet të jetë shtyllë e rëndësishme në procesin edukativo-arsimor. Nxitja dhe zhvillimi i aftësisë kreative-improvizuese të nxënësit ndikohet pozitivisht në lidhjen e tij më të ngushtë me botën muzikore dhe pa mëdyshje rrit interesimin e tij për muzikën. Ky kreativitet ka mundur të shprehet thjesht përmes përcjelljes ritmike të këngëve (me instrumente ritmike), improvizimit të lëvizjeve trupore gjatë këndimit, shprehja përmes vizatimit, përshtypjet që ai ka etj.
- Duke e parë rëndësinë e këtij aktiviteti në procesin mësimor, zhvillimi i kreativitetit të nxënësit duhet zhvilluar në disa drejtime:
- Të nxitet nxënësi që, në bazë të muzikës së dëgjuar, të shprehë përshtypjet, emocionet e veta në forma të ndryshme, përmes arteve të tjera. Mund të bëhet kjo përmes shprehjes figurative apo përmes përshkrimit tekstual mbi veprën e dëgjuar,

në forma të sajimit të ndonjë tregimi të shkurtër apo në formë të krijimit të ndonjë vargu poetik;

- Të nxitet nxënësi që të krijojë (të improvizojë) tërësi të vogla muzikore në bazë të tekstit apo në bazë të ritmit të dhënë;
- Në bazë të një fraze apo fjalie muzikore, të papërfunduar nga arsimtari, nxënësi mund ta vazhdojë dhe ta plotësojë mendimin muzikor.

PLOTËSO



- Kreativiteti është një dhunti individuale, andaj duhet nxitur nxënësit që secili prej tyre të shprehet në mënyrën e vet dhe në mënyrë sa më origjinale;
- Të nxitet nxënësit që në bashkëveprim të improvizojnë një model përcjellës të një kënge të caktuar, me instrumente ritmike (dhe melodike, sipas mundësisë), të cilat i kanë në dispozicion. Praktikisht kjo nënkupton që këta nxënës krijojnë një aranzhman të thjeshtë të këngës me përcjellje instrumentale, të cilin, me ndihmën e arsimtarit mund ta përsosin dhe ta shfaqin në manifestimet e ndryshme shkollore.
- Formë tjetër e kreativitetit të nxënësit mund të jetë edhe nxitja e nxënësve që këngët e njohura t'i ndryshojnë, t'i pasurojnë me nota figurative, që nënkupton të bëjnë një lloj variacioni të këngës.

Krijimtarinë e nxënësit, ndonëse nuk duhet kuptuar dhe nuk duhet trajtuar si krijimtari e mirëfilltë (në mënyrën që do ta bënte kompozitori profesionist), ajo ka rëndësi të madhe për nxënësin, meqë, mes tjerash, ndikon në mënyrë direkte në zhvillimin e raportit të tij ndaj muzikës.

Gjuha dhe komunikimi artistik: **Ta kuptojmë gjuhën e muzikës**

a) Elementet muzikore (ritmi, melodia, harmonia, forma)

Në klasat e mëparshme nxënësi është ndeshur me elementet bazë të muzikës (ritmin, melodinë, harmoninë, formën), para së gjithash, përmes mësimin të këngëve (sipas veshit). Kjo njohje specifike ka qenë vetëm përmes përjetimit të tyre, pa shpjegime teorike për to.

Në fazën e re të mësimin muzikor është e pritshme që nxënësi të fitojë njohuri teorike adekuate, që do ta bëjnë më të lehtë komunikimin e tij me tekstin muzikor. Mu për këtë, nxënësi duhet të fitojë informacione mbi elementet e muzikës (ritmin, melodinë, harmoninë,

formën), jo me shpjegime të thata, por duke i vështruar ato nga “brenda” – nga vetë muzika. Pra, nxënësi me ndihmën e arsimtarit/es do të fillojë ta dallojë çdo element, veç e veç, dhe në vazhdim, do të mësojë rolin e secilit element në kuadër të një kënge, një ushtrimi të thjeshtë, apo në kuadër të një vepre muzikore. Me njohjen e këtyre elementeve, ai do të fillojë ta përvetësojë një gjuhë të re – gjuhën e komunikimit muzikor.

Mënyra më e mirë dhe më e natyrshme është që arsimtari, konceptet e reja (teorike) t’i bëjë të dukshme është mësimi i tyre përmes këngëve që nxënësi i ka të njohura.

Muzika dhe shoqëria: Udhëtimi në botën e ngjyrave muzikore

Zhanret muzikore

- Në muzikë ekzistojnë zhanre muzikore, si *muzika klasike (artistike)*, *muzika popullore*, *muzika zbavitëse*, *muzika xhaz*, *rok muzika* etj. Ato dallojnë për nga lloji i orkestrës që i përdorin, karakteri i tyre, thellësia përmbajtësore dhe ideore e tyre. Mund të dallojnë për nga forma e shprehjes, lloji i instrumenteve që ato përdorin, apo ato mund të dallojnë për ndonjë karakteristikë tjetër.



Çmuarja dhe vlerësimi estetik: Dua ta njoh muzikën më shumë

Përjetimi artistik, zhvillimi i imagjinatës te nxënësit, nxitja e fantazisë së tyre, janë parimet kryesore të metodologjisë së mësimdhënies në fushën e arteve. Duke supozuar se është

punuar shumë me përjetimin artistik në nivelin e parë, në këtë nivel në mënyrë graduale nxënësit njihen me konceptet e ndryshme, dukuritë dhe fenomenet muzikore përmes qasjes konstruktive të të nxënësit.

Një prej komponentëve, në procesin e edukimit dhe arsimimit muzikor, që ndikon në formimin e personalitetit emocional, intelektual dhe, sidomos, të personalitetit social të nxënësit, pa asnjë mëdyshje është **ndërvarësia**. Muzika, si një asnjë lloj tjetër i artit, është ajo që më së shumti i lidh individët (në këtë rast, nxënësit) të veprojnë në kolektivitet. Këndimi dhe muzikimi i përbashkët gjatë procesit mësimor dhe sidomos ato në nivel të shkollës, siç është veprimtaria e korit dhe orkestrës, janë të një rëndësie të veçantë, meqë kultivojnë kulturën e bashkëveprimit, që nënkupton përshtatjen e aktivitetit individual veprimit kolektiv. Nxënësi, në këtë mënyrë, do të mësohet të koordinojë aktivitetin e vet me kërkesat e përbashkëta.

Organizimi i korit dhe orkestrës shkollore

Aktivitet që organizohen në nivel të shkollës, në radhë të parë aktivitetet me pjesëmarrjen në kor dhe orkestër (formacione të ndryshme instrumentale), janë të një rëndësie fundamentale, meqë ato ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe kultivimin e lidhjes së fortë të nxënësit me muzikën. Duke nxitur nxënësit (sidomos ata që dallohen posaçërisht për talentin e tyre) për këto aktivitet, arsimtari/ja mund të ndikojë te nxënësit në kultivimin e lidhjes së tyre më afatgjatë me muzikën, qoftë si dashamirë besnikë i muzikës apo të ndikojë edhe në zgjedhjen e përcaktimit të tyre jetësor për t'iu kushtuar muzikës.

Kori i shkollës është formë më e përhapur e muzikimit kolektiv. Nëse kultivohet drejt, këndimi koral paraqet shkallën më të lartë të arsimimit muzikor në shkolla. Kjo nënkupton këndimin e parturave me dy dhe tre zëra. Duhet përjashtuar këndimin e këngëve korale njëzanore, për shkak se atëherë e humb kuptimin ky aktivitet aq specifik. Këndimi koral zhvillon aftësinë psiko-motorike të nxënësit; ndikon që ai të aftësohet të jetë i vëmendshëm në realizimin e disa detyrave njëkohësisht, meqë ai duhet të jetë i kujdesshëm në saktësi melodike, ritmike, harmonike, tempit dhe, mbi të gjitha, duhet të jetë i vëmendshëm në bashkëveprim simultan me shokët e vet.

Orkestra shkollore është një ansambël instrumental që nënkupton, më së paku 10 instrumentistë. Formacioni orkestral mund të përbëhet prej instrumenteve të të njëjtin lloj (p.sh., orkestra e blokflauteve, orkestra e Orfit etj.) apo prej instrumenteve të ndryshme, me të cilat disponon shkolla. Me rëndësi është që partiturat orkestrale të jenë të përbëra prej disa vijave melodike (që do të thotë të evitohen luajtja në unisono).

Me pjesëmarrjen në kor dhe në orkestër, nxënësi do të bëhet i vetëdijshëm se përmes këtyre aktiviteteve, ai/ajo bashkë me shoqet/ët e vet veprojnë në arritjen e një qëllimi të përbashkët, duke gërshetuar aftësitë individuale me ambiciet e kolektivitetit. Kjo nënkupton zhvillimin dhe kultivimin e një niveli më të lartë të vetëdisiplinës.

Interpretimi në ansamble kamertale të shkollës

Interpretimi në grupe

Nëse nuk ka mundësi që arsimtari të organizojë aktivitetet stabil me orkestër, atëherë me nxënësit e interesuar dhe me një aftësi më të theksuar muzikore mund të organizojë edhe formacione më të vogla instrumentale.

Pasi që nxënësit kanë mësuar shkrim-leximin bazë muzikor, luajtja (interpretimi) në instrumente melodike dhe ritmike, mund të bëhet edhe në grupe, duke pasur kujdes që në to të aktivizohen, në veçanti, nxënësit që për ndonjë arsye kanë vështirësi në këndim. Në këtë mënyrë edhe këta nxënës do të shijojnë mundësinë e afirmimit të tyre. Përgjithësisht, muzikimi grupor duhet të organizohet dhe të përgatitet në atë mënyrë që ai t'u krijojë kënaqësi të gjithë nxënësve.

- Në fillim, arsimtari/ja mund t'i shfrytëzojë si literaturë bazë këngët që punohen gjatë vitit. Përpos kësaj, libri posedon një listë të gjerë të kompozimeve (në faqet e fundit të saj), të destinuara pikërisht për këtë qëllim. Këto kompozime të shkurtra instrumentale mund të realizohen në klasë, por gjithashtu ato mund të inkuadrohen në programet publike që organizohen në nivel të shkollës dhe në nivel të komunitetit.

-Aarsimtari/ja duhet të ketë parasysh që këto kompozime, përveçse realizohen në formën e tyre themelore, me instrumente që janë të përcaktuara në partiturë, mund të realizohen edhe në instrumente të tjera, d.m.th., zgjedhja e instrumenteve bëhet sipas dëshirës dhe sipas mundësive që ka në dispozicion shkolla (kabineti i shkollës). Për më tepër, këto formacione mund të jenë aq variabile, sa që nxënësit dhe arsimtari mund t'u qasen në mënyrë të lirë dhe kreative, me ç'rast në përbërjen e formacioneve që do ta realizojnë mund të shtojnë edhe instrumente të tjera, të cilat nxënësit i zotërojnë individualisht (violinën, fizarmonikën, flautin si dhe instrumente të ndryshme ritmike).

Vlerësimi

Duke e ditur që aftësia individuale e nxënësit është determinuese për suksesin në mësimin dhe edukimin muzikor, është e rëndësishme që arsimtari ta njohë potencialin dhe talentin e çdo nxënësi veç e veç. Ai duhet ta ketë parasysh se aftësitë individuale nuk kanë performancën e njëjtë në të gjitha segmentet shprehëse: nxënësi mund të ketë vesh të shkëlqyeshëm muzikor, por jo edhe dhunti për këndim. Mund të dallohet për zë të bukur, por, në anën tjetër, të ketë mangësi në ndjenjën për ritëm.

Së këndejmi, arsimtari me vëmendje e përcjell nxënësin, duke afirmuar aftësitë individuale të nxënësit.

- Vlerësimi i kompetencës së nxënësit nuk duhet të jetë i njëanshëm dhe të konsiderojë vetëm talentin dhe muzikalitetin e nxënësit.
- Vlerësimi nuk duhet të lidhet vetëm me muzikalitetin e nxënësit, sepse arsimtari do të vlerësojë në mënyrë të njëjtë edhe angazhimin, interesimin dhe dashurinë e nxënësit ndaj muzikës.
- Vlerësimi i drejtë dhe i saktë duhet të shërbejë si motivim për nxënësin. Portofoli i nxënësit duhet të përfshijë të gjitha rezultatet individuale dhe angazhimet në procesin mësimor dhe angazhimet në aktivitetet në grup, në nivel të shkollës.

Tema: Himni kombëtar

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Krijimtaria dhe performanca artistike; çmuarja dhe vlerësimi estetik- artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Himni kombëtar, Kosova, shteti, simbolet kombëtare

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Historia

Përforcimi i aftësisë: Dëgjimi

Elementi në fokus: Timbri

Mjetet e punës: Auditive - CD

HIMNI I KOSOVËS

Mendi Mengjiqi



ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/ja, në fund të orës:

- do ta njohë himnin e Kosovës.
- do të jetë i informuar dhe ta njohë veprimtarinë dhe jetën e kompozitorit të himnit.
- do të njoftohet me simbolet e vendit

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Nxënësit me mësimdhënësin/endo ta dëgjojnë “Himnin e Kosovës”.
- Mësimdhënësi/ja mund të zhvillojë një bisedë me nxënësit lidhur me datat historike të vendit.
- Nxënësit do të mësojnë rëndësinë e himnit kombëtar dhe himnit shtetëror.

Informacion për mësimdhënësin/en:

Mendi Mengjiqi (lindur më 1958 në Podujevë) është autor i himnit shtetëror të Republikës së Kosovës. Ai i takon gjeneratës së mesme të krijuesve kosovarë.

Tema: Zilja po na fton**Koncepti bazë i fushës së kurrikulës:** Krijimtaria dhe performanca artistike;

Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë**Klasa:** 6**Fjalët kyçe:** Shkolla, solmizimi, shkalla C-dur**Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):** Gjuhë dhe komunikim, Shoqëria dhe mjedisi**Përforcimi i aftësisë:** Këndimi**Elementi në fokus:** Mësimi i këngës sipas veshit, melodia, elementet muzikore / shkrim-leximi muzikor**Mjetet e punës:** Auditive - CD**Zilja po na fton**L. Deda
D. Angoni

Tring e tring e tring zi - lja po na th'rret. lam - tu - mir pu - shi - me
shko - lla po na pret pret. Me lu - le n'du - ar m'su-sen e rre -
thojm'. të gjith' të gë - zu - ar kla - sën po shi - koj'm'. Tring e tring e
tring zi - lja po na th'rret. lam - tu - mir pu - shi - me shko - lla po na pret.

I
Tring e tring e tring,
zilja po na th'rret.
Lamtumir' pushime,
shkolla po na pret.

II
Me lule n'duar,
msuesen e rethojm,
Të gjith' të gëzuar,
klasën po shikojm'.

III
Tring e tring e tring,
zilja po na th'rret.
Lamtumir' pushime,
shkolla po na pret.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT**Rezultatet e të nxënit**

- të mësojë artikullimin dhe shqiptimin e drejtë të tekstit poetik.
- të dijë ta këndojë këngën me emocion të duhur.
- ta kujtojë dhe ta zotërojë njohjen e shkallës C-dur.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Mësimdhënësi/ja do ta demonstrojë këngën, duke e kënduar me artikullim të qartë, me shqiptim të drejtë të tekstit, me intonim të pastër.
- Mësimdhënësi/ja do ta shpjegojë përmbajtjen e tekstit, do të flasë për bukurinë poetike të tekstit, do të shquajë fjalët kyçe të tekstit, gjithmonë duke nxjerrë në pah porosinë thelbësore që këngë ka.
- Së pari teksti i këngës ligjërohet me ritmin e këngës. Pastaj, melodia e këngës mësohet e ndarë në fraza apo pjesë më të vogla. Frazën së pari e këndon mësimdhënësi/ja dhe pastaj nxënësit atë e imitojnë. Kështu vazhdohet me frazat e tjera të këngës. Ndonëse është e mundshme të përdoret instrumenti përcjellës (e preferueshme është përdorimi i ndonjë instrument harmonik), këndimi i mësimdhënësit/es është vendimtar.
- Pasi të mësohen fragmentet e këngës, kalohet në këndimin e tërësishëm të këngës. Në vazhdim mësimdhënësi/ja do të këndojë perseri këngen me dinamike, me shprehje, me këndim të drejtë dhe në mënyrë sugjестive që nxënësi të mundet më lehtë ta memorizojë këngën në tërësi.

Tema: Fillet e muzikës në trevat shqiptare

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Krijimtaria dhe performanca artistike; Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Muzika shqiptare, historia, Niketë Dardani, Ulpiana, Jan Kukuzeli, Gjergj Danush Llapacaj, ilirët, okarina

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Histori, arkeologji

Përforcimi i aftësisë: Dëgjimi, historia e muzikës

Elementi në fokus: Elementet muzikore / shkrim i vjetër muzikor

Mjetet e punës: Auditive - CD , video projektor, internet

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/ja, në fund të orës:

- Njihet me traditën e hershme muzikore shqiptare.
- Njihet me instrumentin antik – okarinën.
- Njeh kompozitorët me origjinë shqiptare të shekujve IV, XIII dhe XVI.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Mësimdhënësi/ja flet për krijuesit e parë shqiptarë: për Niketë Dardanin, i cili shkruante në gjuhën latine këngë dhe himne; për Jan Kukuzeli (shek. XIII), që në historinë e muzikës së përbotshme njihet si reformator i madh i shkrimit muzikor dhe për Gjergj Danush Llapacajn (shek. XVI), krijues i gjithanshëm, me prejardhje nga Durrësi, i cili jetoi dhe veproi në Itali.
- Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve okarinën, instrument i vjetër, i gjetur në Ulpianën antike dhe instrument që dardanët e kanë përdorur në festat dhe ahengjet e tyre.
- Nxënësit dëgjojnë veprën “*Te Deum*”, të Niketë Dardanit dhe *Koralet* e Gjergj Danush Llapacajt.
- Mësimdhënësi/ja nxit diskutimin lidhur me veprat e dëgjuara.

Tema: Si të luajmë në blokflaut?

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Krijimtaria dhe performanca artistike; Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Blokflauti, fyelli, teknika e interpretimit, interpretim


Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):

Përforcimi i aftësisë: Interpretimi

Elementi në fokus: Shkrim-leximi muzikor

Mjetet e punës: Blokflauti, ilustrime, pasqyrë e interpretimit në blokflaut, partitura

Eshte e preferueshme që mësimdhënësi/ja t'i nxisë nxënësit ta përvetësojnë blokflautin, meqë është instrument, i cili lehtë mund të zotërohet nga shumica e nxënësve. Nxënësit mund të forjmojnë grupe që të interpretojnë se bashku.



ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/ja, në fund të orës:

- do të dijë të mësojë qëndrimin e drejtë gjatë luajtjes së blokflautit.
- do të mësojë të luajë në blokflaut dhe të interpretoj sipas notave muzikore.
- do të luajë duke respektuar simbolet e mësuara.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Në fillim të orës nxënësit do të njohin blokflautin dhe ndërtimin e instrumentit.
- Është shumë e rëndësishme që gjatë luajtjes në instrument, qëndrimi të jetë i drejtë dhe kjo mund të bëhet duke u kërkuar nxënësve që ata të qëndrojnë në karriget e tyre (si në ilustrimet në libër) dhe të ulen në gjysmën e karrigës, duke mbajtur blokflautin 30-45 gradë larg gjoksit.
- Në vazhdim, arsimtari/ja do t'u japë shpjegime nxënësve lidhur me pozicionet e dorës, të cilat do të duhen gjatë interpretimit të blokflautit dhe lartësive të ndryshme.

Këshillë mësimdhënësit/es

Në vazhdim mund shfrytëzoni si literaturë të përshtatshme ndonjë ushtrim nga faqet e fundit të librit të nxënësit dhe t'i praktikoni bashkërisht në blokflaut. Nëse nxënësit arrijnë ta përvetësojnë mirë instrumentin, ju mund të vazhdoni dhe të hulumtoni partitura dhe ushtrime të ndryshme nga burime të tjera.

Tema: Muzika klasike në Kosovë

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Muzika dhe shoqëria

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Muzika klasike, Kosovë, kompozitorët dhe interpretues kosovarë, institucionet muzikore

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Histori

Përforcimi i aftësisë: Dëgjimi

Elementi në fokus: Historia e muzikës kosovare

Mjetet e punës: Auditive - CD

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënimit

Në fund të orës:

- Nxënësi njeh interpretues të shquar kosovarë.
- Nxënësi njeh kompozitorët kosovarë të muzikës klasike.
- Nxënësi njeh institucionet themelore muzikore në vend.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Mësimdhënësi/ja bën një përshkrim të shkurtër të zhvillimit historik të muzikës klasike në Kosovë që nga themelimi i shkollës së parë të muzikës në Prizren dhe aktivitetit që zhvillon shoqëria "Agimi", duke theksuar kontributin e kompozitorëve të gjeneratës së parë, Lorenc Antoni e Rexho Mulliqi, duka vazhduar më pas me kompozitorët e tjerë të shkolluar, si: Esat Rizvanolli, Fahri Beqiri, Vinçenc Gjini, Mark Kaçinari etj.
- Mësimdhënësi/ja thekson rëndësinë e institucioneve muzikore në vend, me ç'rast përmend formimin e institucioneve gjatë viteve '70-ta, si: orkestra simfonike e Radio Televizionit të Prishtinës, Kori profesional i RTP-së, formimi i Akademisë së Muzikës etj.
- Mësimdhënësi/ja prezanton shkurtazi progresin në fushën e muzikës klasike me aktivitetin e kompozitorëve tanë të shkolluar, si: Zeqirja Ballata, Bahri Çela (dirigjent), Rauf Dhomi, Bajar Berisha (dirigjent), Rafet Rudi, Bashkim Shehu etj., pastaj

gjeneratës së mesme të muzikantëve kosovarë Mendi Mengjiqi, Valton Beqiri, violinistja Sihana Badivuku, pianistet Lejla Pula e Valbona Petrovci, flautistja Venera Mehmetagaj.

- Mësimdhënësi/ja thekson se në dy deceniet e fundit muzika klasike te ne përjeton një ngritje të madhe. Për aktivitet më të shënueshëm shquhet gjenerata më e re e kompozitorëve si Kreshnik Aliçkaj, Dafina Zeqiri, Drinor Zymberi, Kushtrim Gashi, Donika Rudi, Lyra Katrati etj. Me paraqitje të rëndësishme në skenën ndërkombëtare shquhen: kitaristi Petrit Çeku, tenori Ramë Lahaj, soprano Elbenita Kajtazi, Marigona Qerkezi, Besa Llugiqi etj.

Këshillë arsimtarit/es

- Gjatë orës, bashkërisht do të dëgjohen shembuj nga interpretues kosovarë si dhe mund të shikohen përmes internetit dhe video–projektorit performancat e shkëlqyera të artistëve, si: Petrit Çekut (kitarist), Ramë Lahaj (tenor) dhe soprano Elbenita Kajtazi, Marigona Qerkezi, Besa Llugiqi në skenat ndërkombëtare.

Dëgjim: Petrit Çeku, kitarist (pjesë nga suita e Bahut)

Tema: Të përkujtojmë dhe të mësojmë masat

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Masat e thjeshta, $2/4$, $3/4$, $4/4$

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Matematikë

Përforcimi i aftësisë: Konceptet themelore ritmike

Elementi në fokus: Ritmi

Mjetet e punës: Ilustrime, partitura

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënimit

Nxënësi/ja, në fund të orës, duhet :

- të njohë konceptet themelore ritmike.
- të interpretojë në masa të ndryshme.
- të organizojë dhe të identifikojë masat në krijimin e vet muzikor.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

- Nxënësi duhet të identifikojë theksin muzikor, i cili gjithmonë duhet të jete ne përputhje me theksin e tekstit të këngës. Nxënësi do të vërejë se gjithmonë rrokjet në fillim të masës janë të forta, kurse në lëvizjet e dyta rrokjet janë më të buta.
- Që ta kuptojë rëndësinë e theksit mësimdhënësi/ja mund të ligjërojë një tekst me vendosjen e gabuar të theksit. Nxënësi, pa mëdyshje do ta vërejë dallimin dhe rëndësinë e theksit të drejtë, si kusht i domosdoshëm që një tekst të jetë i kuptueshëm.
- Rjedhimisht kësaj, nxënësi do ta kuptojë rolin e **masës**. Pra, nxënësi do të vërejë se bashkimi i një pjese të theksuar, që quhet **teza** dhe një pjese të patheksuara, të cilën e quajmë **arza**, e përbën masën (në këtë rast masën dypjesore $2/4$).

Tema: Valsi dhe marshi

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Gjuha dhe komunikimi artistik; Çmuarja dhe vlerësimi estetik- artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Valsi, marshi, masat e thjeshta

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Matematikë, Gjuhët dhe komunikimi

Përforcimi i aftësisë: Dëgjimi, forma muzikore, konceptet themelore ritmike

Elementi në fokus: Ritmi

Mjetet e punës: Auditive, CD player

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/ja në fund të orës:

- do të mësojë masat përmes dëgjimit.
- do të mësojë për kompozitorin e shquar të valsit, Johan Strauss.
- do të plotësojë dhe do të bëjë detyra e ushtrime, duke demonstruar se e ka kuptuar qartë masën

2/4, 3/4 dhe 4/4

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE



Ecuria e punës

- Nxënësit do të dëgjojnë **Johan Strauss "Danubi Blu"** dhe ata do të nxiten që të shprehin me fjalët e tyre se çfarë emocionesh sjell kjo vepër.
- Nxënësit do të njihen edhe me vallëzimin tipik të valsit përmes ilustrimeve (apo përmes internetit) duke dëgjuar e shikuar vallëzimin e valsit.
- Mësimdhënësi/ja do t'u shpjegojë nxënësve se marshi paraqet një lloj muzike që ngjason në valle, meqë në bazë të saj zhvillohen lëvizjet e caktuara.

Me muzikën e marshit ecet dhe marshohet. Marshi ka një karakter solemn, me ritëm të vendosur dhe të prerë. Është në masën 2/4 dhe 4/4/.

Këshillë mësimdhënësit/es

Nxitni nxënësit që të flasin për eksperiencën e dëgjimit të veprave dhe përjetimin e tyre.

Tema: Temë me variacione**Paramasa****Koncepti bazë i fushës së kurrikulës:** Gjuha dhe komunikimi artistik**Lënda:** Muzikë**Klasa:** 6**Fjalët kyçe:** Temë me variacione, paramasa, paratakti, Mozart,**Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):****Përforcimi i aftësisë:** Dëgjimi, forma muzikore, konceptet themelore ritmike**Elementi në fokus:** Dëgjimi**Mjetet e punës:** Auditive - CD, liber**Tema / mendimi kryesor /****Variacionet**

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

- të njohë konceptin e variacioneve.
- duhet të jetë i aftë që me ndihmën e mësimdhënësit/es të krijojë shembuj (variacione) duke improvizuar në bazë të një teme (mendim) muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Mësimdhënësi/ja do të shpjegojë konceptin e variacioneve përmes dëgjimit të disa shembujve të kësaj forme.
- Tema me variacion është formë muzikore, e cila përbëhet prej një teme dhe përsëritjeve të saj, gjithmonë të ndryshuara. Numri i variacioneve nuk është gjithmonë i njëjtë, ai sillet prej 2-3 deri në 33 variacione.
- Mësimdhënësi/ja, bashkë me nxënësit, analizojnë shembullin notal, i cili figuron në Librin e nxënësit.
- Mësimdhënësi/ja do t'ua bëjë të qartë nxënësve se forma e temës me variacion bazohet në një temë, e cila përsëritet, por e cila vjen gjithmonë e ndryshuar dhe e modifikuar.
- Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve se temë me variacione kanë kompozuar shumë kompozitorë.

Dëgjim muzikor:

Mozart: Variacione mbi një temë franceze dhe në vazhdim të diskutojnë lidhur me dëgjimin

Paramasa:

- Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve se kënga mund të fillojë me rrokje të patheksuar. Gjithashtu, një frazë melodike mund të fillojë me një notë, në pjesën e patheksuar të masës. Këtë notë e quajmë paramasë. Zakonisht paramasa plotësohet me masën e fundit. Kjo nënkupton se paramasa dhe masa e fundit e përbëjnë (bashkërisht) një masë të vetme.
- Mësimdhënësi/ja me nxënësit analizojnë bashkërisht ushtrimet melodike që fillojnë me paramasë.

Tema: Kori gazmor dhe shkalla G-dur**Koncepti bazë i fushës së kurrikulës:** Krijimtaria dhe performanca artistike; Gjuha dhe komunikimi artistik**Lënda:** Muzikë**Klasa:** 6**Fjalët kyçe:** Shkalla G-dur, kori gazmor, mësimi i këngës me tekst notal**Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):** Gjuhë dhe komunikim, shoqëria dhe mjedisi**Përforcimi i aftësisë:** Këndimi**Elementi në fokus:** Melodia, elementet muzikore / shkrim-leximi muzikor**Mjetet e punës:** Auditive - CD

Kori gazmor

B. Shehu
R. Pasmaçiu

Allegro

Lart e posht' në o - borr po kë - don një kor ga - zmor. Pa - ta bën ga - ga - ga

pu - la e ku - qe kua - kua - kua. Ky është ko - ri yn' ga - zmor,

që jep shfa - qje te ne në o - borr. te ne në o - borr

II

Lart' e posht' në oborr
po këndon një kor gazmor.
Gjeli bën ki-ki-ki,
zogu i vogël ciu-ciu-ci.

Ref:

Ky është kori...

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/ja, në fund të orës, duhet:

- të ketë artikullim të qartë dhe shqiptim të drejtë të tekstit.
- të intonojë pastër melodinë e këngës.
- ta këndojë këngën me emocion të duhur.
- ta kujtojë dhe ta zotërojë njohjen e shkallës G-dur.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Teksti i këngës do të ligjërohet me ritmin e këngës. Pastaj, melodia e këngës mësohet e ndarë në fraza apo pjesë më të vogla.
- Mësimdhënësi/ja e këndon frazën dhe pastaj nxënësit atë e imitojnë. Kështu vazhdohet me frazat e tjera të këngës. Përvetësimi, pra, bëhet me këndim alternativ të arsimtarit dhe nxënësve, të cilët kanë detyrë t'i përsëritin frazat.
- Ndonëse është e mundur të përdoret instrumenti përcjellës (e preferueshme është përdorimi i ndonjë instrument harmonik), këndimi i mësimdhënësit/es është vendimtar.
- Pasi që mësohen fragmentet e këngës, kalohet në këndimin e tërësishëm të këngës. Mësimdhënësi/ja përsëri do ta demonstrojë këngën, tashti duke i shquar, sa më shumë vlerat artistike të këngës. Ai do të këndojë me nuancime të duhura dinamike, me shprehje, me këndim të drejtë dhe në mënyrë sugjестive që nxënësi të mundet më lehtë ta memorizojë këngën në tërësi.

Tema: Vjeshta / prima sekunda volta**Koncepti bazë i fushës së kurrikulës:** Krijimtaria dhe performanca artistike; Gjuha dhe komunikimi artistik**Lënda:** Muzikë**Klasa:** 6**Fjalët kyçe:** Vjeshta, prima volta, sekonda volta, konceptet e përsëritjes**Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):** Gjuhë dhe komunikim, shoqëria dhe mjedisi**Përforcimi i aftësisë:** Këndimi dhe forma muzikore**Elementi në fokus:** Melodia, elementet muzikore / shkrim-leximi muzikor**Mjetet e punës:** Auditive, përmes CD player

Vjeshta

S.Spahiu
M.A. Hoxha**Gëzueshëm**

mf Kur vjen vje-shta nje-rë - zi - a mble - dhin fry - tet me kuj - des *p* ndër shu

lla ne plot laj - thi - a mble-dhin fmi - ja pa pri - tes

ndër shu fmi - ja pa pri - tes

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxëniet

Nxënësi/ja, në fund të orës, duhet:

- ta shqiptojë tekstin drejt.
- të intonojë pastër.
- ta këndojë këngën duke respektuar shenjat e përsëritjes.
-

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Në fillim të orës Mësimdhënësi/ja me nxënësit do të diskutojnë për stinën e vjeshtës dhe të mirat që sjell kjo stinë; diskutojnë për ndryshimin e pamjes së natyrës dhe ngjyrat e natyrës që sjell kjo stinë.
- Diskutimi mund të zhvillohet edhe për rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe mjedisit.
- Do të diskutojnë lidhur me tekstin e këngës dhe në vazhdim do të fillojnë ta punojnë atë përmes metodologjisë tashmë të njohur. Melodia e këngës mësohet e ndarë në fraza apo pjesë më të vogla.
- Këndimin e frazës, së pari e këndon arsimtari dhe pastaj nxënësit atë e imitojnë. Përvetësimi, pra, bëhet me këndim alternativ të arsimtarit dhe nxënësve, të cilët kanë detyrë t'i përsëritin frazat.

Mësimdhënësi/ja do t'u shpjegojë nxënësve shenjat që ekzistojnë mbi nota. Ata do të vërejnë se është fjala për shenjat e përsëritjes, që në muzikë i quajmë *prima volta* dhe *sekonda volta*.

- Mësimdhënësi/ja në fillim duhet ta përsërisë dhe t'i sqarojë shenjat e përsëritjes, funksionin dhe rëndësinë e tyre.
- Mësimdhënësi/ja e luan apo e këndon këngën "**Vjeshta**", duke i respektuar shenjat e përsëritjes. Nxënësit do të vërejnë se masa mbi të cilën është shënuar **prima volta** këndohet vetëm herën e parë, në përsëritje kjo masë kalohet. Shenja **sekunda volta** tregon taktin të cilin duhet kënduar në përsëritje.

Tema: Oda e gëzimit

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Muzika dhe shoqëria; çmuarja dhe vlerësimi estetik-artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Vjeshta, prima volta, sekonda volta, konceptet e përsëritjes

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Histori, Gjuhë dhe komunikim, Shoqëria dhe Mjedisi

Përforcimi i aftësisë:

Elementi në fokus: Dëgjim

Mjetet e punës: Auditive - CD

Oda e Gëzimit

L. V. Beethoven

Moderato

The image shows a musical score for 'Oda e Gëzimit' by L. V. Beethoven. It is in 3/4 time and D major. The score is divided into four systems, each with a Violin part on the top staff and a Piano part on the bottom staff. The tempo is marked 'Moderato'. The first system starts with a forte (f) dynamic for the violin and mezzo-forte (mf) for the piano. The second system features a fortissimo (ff) dynamic for the violin. The score concludes with a double bar line.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/ja, në fund të orës:

- do të njihet me himnin e Evropës.
- do të njihet me jetën dhe veprimtarinë e kompozitorit Beethoven.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Nxënësit do të njihen me jetën dhe veprimtarinë e kompozitorit Beethoven dhe do ta dëgjojnë himnin e Evropës, i njohur ndryshe edhe si 'Oda e gëzimit'. Mësimdhënësi/ja do t'u shpjegojë nxënësve se ky është himni i Këshillit të Evropës dhe i Bashkimit Evropian

Informacion për mësimdhënësin/en

Ludvig van Beethoven është një nga figurat më të rëndësishme të historisë së muzikës. Që nga moshë e re Beethoven humbi dëgjimin, por përkundër kësaj, ai vazhdoi të krijojë deri në fund të jetës së tij.

Tema: Libri i historisë / kompozitorët shqiptarë

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Krijimtaria dhe performanca artistike; muzika dhe shoqëria

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Libri i historisë, kompozitorët shqiptarë: Rexho Mulliqi, Lorenc Antoni, Prizreni

Çështjet e ndërlydhura (korrelacioni): Histori, Gjuhë dhe komunikim, shoqëria dhe mjedisi

Përforcimi i aftësisë: Këndimi


Elementi në fokus: Melodia, njohja me krijimtarinë kombëtare

Mjetet e punës: Auditive, përmes CD player, ilustrime

Libri i historisë

Donika Rudi
H. Morina

Gëzueshëm



ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/ja, në fund të orës, do të mësojë:

- ta respektojë shqiptimin e drejtë të tekstit.
- ta intonojë pastër melodinë e këngës.
- ta këndojë këngën me emocion të duhur.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Në fillim të orës Mësimdhënësi/ja do ta shpjegojë përmbajtjen e tekstit, do të flasë për bukurinë poetike të tekstit, pastaj do të shquajë fjalët kyçe të tekstit, gjithmonë duke nxjerrë në pah porosinë thelbësore që ka kënga.
- Meqë nxënësit tashmë kanë njohuri mbi notat, mbi vlerat e tyre dhe shenjat e ndryshme që e përcjellin një tekst notal, leximi notal do të jetë në fokus.
- Arsimtari/ja do të nxisë nxënësit që në vazhdimësi të diskutojnë lidhur me mënyrat e interpretimit dhe për shenjat e ndryshme muzikore, të cilat ndikojnë në mënyrat e shprehjes.

Meqë kënga lidhet me historinë, arsimtari/ja do të hapë diskutimin lidhur me traditën e gjatë kombëtare të vendit tonë. Në klasë do të flitet për historinë që lidhet me shumë qytete të Kosovës, ndër të cilat shquhet pa mëdyshje Prizreni.

- Vlen të përmendet që në fund të shek.. XIX është zhvilluar ngjarja më e rëndësishme e traditës kombëtare, Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Pas Luftës së Dytë Botërore, si kryeqytet i Kosovës për disa vjet me radhë, Prizreni dallohet për aktivitet të rëndësishme kulturore.
- Shkolla e parë e muzikës në Kosovë u themelua pikërisht në Prizren. Aty edhe filluan veprimtarinë e tyre muzikantët e parë **Lorenc Antoni** dhe **Rexho Mulliqi**. Prizreni është qytet që ka traditë të gjatë kulturore dhe historike. Ky qytet është shpallur Kryeqytet historik i Kosovës.

Këshillë mësimdhënësit/es

- Nxitni nxënësit që të hulumtojnë dhe të prezantojnë mënyra të ndryshme të interpretimit. Në vazhdim të kësaj, nxitni ata që ta ndryshojnë dinamikën, ritmin etj., dhe pastaj të vetëvlerësojnë rezultatin e arritur.
- Pyetni nxënësit nëse kanë dëgjuar vepra të autorëve të lartpërmendur. Cilat janë mendimet e tyre për ta?

Dëgjojmë veprat korale:

Lorenc Antoni: Hypi Cuca

Rexho Mulliqi: Vjeshta

Tema: Instrumentet muzikore I, II dhe III

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Muzika dhe shoqëria

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Instrumente muzikore, piano, harpa, timpani, klavseni, organo

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni):

Përforcimi i aftësisë: Dëgjimi, njohja e instrumenteve

Elementi në fokus: Dëgjimi

Mjetet e punës: Auditive - CD player

Në princip, çdo objekt i cili krijon tingull (përmes goditjes, fryrjes, fërkimit etj.) konsiderohet instrument. Në kohët e vjetra instrumentet muzikore kanë shërbyer në rituale, sinjale, ceremoni religjioze apo edhe thirrje ose mobilizim ushtarak.

Instrumentet muzikore ndahen në tri kategori kryesore:

- Instrumentet me tela,
- Instrumentet frymore,
- Instrumentet me goditje.

Përpos këtyre grupeve kryesore të instrumenteve, dallojmë edhe instrumente të tjera, si:

- Instrumentet me tastierë,
- Instrumentet elektronike.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/ja, në fund të orës, duhet:

- të njohë dhe të dallojë instrumentet me tela, me goditje, me frymë dhe instrumentet me tastierë.
- të identifikojë instrumentet në bazë të dëgjimit.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Mësimdhënësi/ja u kujton nxënësve përmes dëgjimit instrumentet që ata i kanë mësuar më parë dhe kërkon prej tyre që t'i identifikojnë përmes fotove dhe përmes dëgjimit.

Mësimdhënësi/ja në vazhdim do t'u shpjegojë instrumentin e **harpës**, duke u shpjeguar nxënësve se harpa është instrument me tela dhe i cili ka një tingull të ëmbël dhe të qetë. Mësimdhënësi/ja do t'u shpjegojë nxënësve se harpën më shpesh e hasim në kuadër të orkestrës, por që ajo përdoret edhe si instrument solistik. Kompozitori francez, Klod Debysy (Claude Debussy), është njëri prej krijuesve më të njohur, i cili me përkushtim të madh e përdor harpën në veprat e veta.

Dëgjim muzikor: Claude Debussy: Danse sacrée et danse profane

Në vazhdim të orës mësimdhënësi/ja do të flasë edhe për **pianon**, si një ndër instrumentet më të popullarizuara.

Mësimdhënësi/ja do t'u shpjegojë nxënësve se pianoja njëri prej instrumenteve më të popullarizuar që nga shekulli XVII. Të gjithë kompozitorët e njohur kanë shkruar vepra të shumta në instrumentin e pianos, ndër ta duhet veçuar kompozitorët Franc Listi, Frederik Shopen dhe Pjetër Iliq Çajkovski.

Shembulli për dëgjim:

Pyotr Ilyich Tchaikovsky: Kënga e vjeshtës nga "The Seasons"

- Instrumentet muzikore janë pjesë e rëndësishme e edukimit muzikor të nxënësit. Kënaqësia e dëgjimit do të jetë edhe më e madhe kur ata njohin më mirë instrumentet. Ata duke njohur instrumentet më afër, do të arrijnë ta dëgjojnë veprën duke vërejtur instrumentet veç e veç, duke dalluar timbrin e instrumentit dhe duke dalluar llojet e orkestrave.
- Mësimdhënësi/ja do të flasë për **organon**, i cili për dallim nga instrumentet e tjera me tastierë, ajo ka edhe tastierët pedalikë, në të cilat luhet me këmbë. Tingulli i organos është i fuqishëm dhe ai fitohet duke shtypur tastierët. Sa më të hollë janë gypat, tingulli është më i lartë dhe sa më voluminozë që janë gypat, tingulli është më i ulët. Kompozitorët që kanë shkruar për organon janë: Hendëll, Ditrih Bukstehude, Cezar Frank, Olivie Mesjen etj.

Në vazhdim bashkërisht do të dëgjojmë:

Johann Sebastian Bach: Dorian Toccata në d-mol, BÈV 538

- **Klavseni** ka ngjashmëri të madhe me pianon dhe është instrumenti më i preferuar i kompozitorëve barokienë (Bah, Hendel, F.Kupren etj.). Tingulli fitohet kur goditja në tastier aktivizon penën, e cila e tërheq (pickëton) telin. Në shekullin XVII nga klavseni zhvillohet instrumenti më i përsosur me tastierë – pianoja.

Shembulli për dëgjim:

François Couperin (Fransoa Kupren): “Le Tic-Toc-Choc”

Nga instrumentet frymore nxënësit në klasat e mëhershme janë njohur me disa nga to. Këtë vit ata do të njihen me një instrument që i takon familjes së instrumenteve të tunxhit. Arsimtari/ja do t’u shpjegojë nxënësve se **briri** apo korna përdoret kryesisht në orkestër dhe ka rolin e mbajtjes së sfondit harmoik. Por atë e gjejmë edhe si instrument solistik dhe në kuadër të formacioneve kamertale (p.sh. në kuadër të kuintetit frymor). Briri ka një tingull të butë, sidomos në regjistrin e ulët, kurse në regjistrin e lartë dhe në dinamikën e fortë mund të jetë dramatike dhe festive.

Shembulli për dëgjim:

Volfgang Amadeus Mozart: Horn Concerto Nr. 3 KV. 447

Nga instrumentet me goditje, pa mëdyshje se instrumenti më i popullarizuar është **timpani**. Para se të dëgjohet tingulli i timpanit përmes dëgjimit, mësimdhënësi/ja do t’u japë nxënësve disa shpjegime për të.

Shembulli për dëgjim:

Philip Glass: Double Concerto for Timpani & Orchestra

Informacion për mësimdhënësin/en

Philipp Glass është kompozitor amerikan dhe njëri ndër pionierët e muzikës minimaliste, krahas kompozitorëve të tjerë të kësaj natyre, si: Steve Reich, Terry Riley. Glass konsiderohet si një ndër kompozitorët më të rëndësishëm të gjysmës së dytë të shek. 20. Përpos veprave të tija kamertale e orkestrale, ai njihet edhe për muzikë filmi, ku në botën e filmit sot është shumë prezent.

Këshillë mësimdhënësit/es

- Është më rëndësi për çdo orë të merret/bëhet një paralele me situatën aktuale në Kosovë, qoftë sa u përket instrumentistëve, ashtu edhe sa u përket institucioneve muzikore në Kosovë. Ju mund të pyetni nxënësit në qoftë se ata dinë nëse ka apo jo organo në Kosovë? A ka pasur ndonjëherë?

Tema: Muzika dhe artet e tjera / Dëgjim: Antonio Vivaldi

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Muzika dhe shoqëria; çmuarja dhe vlerësimi estetik-artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Vjeshta, Vivaldi, piktura, stinët, koncert, violinë, orkestër

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Art figurativ, natyrë, literaturë

Përforcimi i aftësisë: Dëgjimi

Elementi në fokus: Muzika dhe artet e tjera

Mjetet e punës: Auditive - CD player, ilustrime, laps



ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/ja, në fund të orës:

- do të kuptojë se kompozitorët frymëzimin e marrin nga shumë fusha: nga artet e tjera, si poezia, piktura etj. Gjithashtu kompozitorët frymëzimin e gjejnë edhe në bukuritë natyrore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

Para se nxënësit ta dëgjojnë veprën e njohur të Vivaldit, mësimdhënësi/ja do të flasë për disa elemente të rëndësishme të cilat kanë qenë vendimtare në krijimin e kësaj vepre.

Kompozitori Antonio Vivaldi ka shkruar poezitë, mbi të cilat pastaj ka kompozuar veprën e tij shumë të njohur "Katër stinët". Ato janë shkruar në një formë dhe me një rimë shumë specifike, duke përmbajtur kështu me përpikëri 14 linjat në poezi. Përmes tyre ai ka ndërtuar formën e veprës. Poezitë, të cilat kanë shërbyer për kompozimin e veprës "Katër stinët", Vivaldi i ka bazuar në pikturat e artistit italian, Marc Ricci.

Informacion për mësimdhënësin/en

Antonio Vivaldi ishte kompozitor, violinist i frytshëm italian. Shkroi vepra të shumta instrumentale dhe vokale. Për ne shqiptarët, ka rëndësi të veçantë emri i këtij kompozitori të famshëm, meqë Vivaldi është autor i operës "Skenderbeg".

Tema: Sinkopa, tempi, korona

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Sinkopa, dinamika, korona

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Matematikë

Përforcimi i aftësisë: Lexim notal

Elementi në fokus: Shkrim-leximi muzikor

Mjetet e punës: Ilustrimi

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi në fund të orës:

- do ta njohë termin **sinkopë** dhe funksionin e saj.
- do të njohë **koronën** dhe funksionin e saj.
- do ta njohë tempin (shpejtësinë).

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

Mësimdhënësi/ja do t'u shpjegojë nxënësve se në masën e katër të katërtave, lëvizja e parë dhe lëvizja e tretë janë të theksuara, ndërsa lëvizja e dytë dhe lëvizja e katërt janë të patheksuara.

Nëse lëvizjen e dytë të kohës e lidhim me lëvizjen e tretë, theksi në këtë masë do të ndryshojë.

Shembulli i sinkopës:



Këtë dukuri ritmike e quajmë **sinkopë**.

Pra, sinkopa është kalimi i theksit të fortë në atë të butë.

Sinkopa

Muzika: D. Rudi

Teksti: S. Spahiu

Shpejt



Musical notation for the first line of the song 'Sinkopa'. The notation is in 4/4 time and features a treble clef. The melody consists of quarter notes and eighth notes. The lyrics are: Sin - ko - - pë ti ri - tëm që be - fa - son



Musical notation for the second line of the song 'Sinkopa'. The notation is in 4/4 time and features a treble clef. The melody consists of quarter notes and eighth notes. The lyrics are: me thek - sin e nd'rru - ar ti na gë - zon

(Korona) Mësimdhënësi/ja në vazhdim apo në ndonjë orë tjetër do të flasë për koronën, duke treguar se korona është shenjë që tregon se nota zgjatet sipas dëshirës së interpretimit dhe se ajo vendoset mbi notë.

Shembulli i shenjës së koronës:



Musical notation showing a note with a crown symbol above it, representing a coronation. The notation is in 4/4 time and features a treble clef.

Tema: We wish you a Merry Christmas dhe Erdhi Viti i Ri

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Krijimtaria dhe performanca artistike; Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Festat e fundvitit, Christmas, Viti i Ri

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Gjuhë dhe komunikim, shoqëria dhe mjedisi

Përforcimi i aftësisë: Këndimi

Elementi në fokus: Melodia, lexim notal, shkrim dhe lexim muzikor

Mjetet e punës: Auditive - CD player

We Wish You a Merry Christmas



1. we wish you a mer-ry Christ-mas, we wish you a me-ry
bring us some fi-gy pud-ding, now bring us some fig-gy
won't go un-til we get some, we won't go un-til we
wish you a mer-ry Christ-mas, we wish you a mer-ry



Christ-mas, we wish you a me-ry Christ-mas, and a Hap-py New Year! God
pud-ding, now bring us some fig-gy pud-ding, and - a cup of good cheer.
get some, we won't go un-til we get some, so__ bring some out here!
Christ-mas, we wish you a mer-ry Christ-mas, and - a Hap-py New Year!

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

- Nxënësi aftësohet që të mësojë këngët përmes tekstit notal.
- Zgjerimi i njohurive teorike (shkallët mol, diezi etj.)
- Zhvillimi i veshit melodik.
- njohja e shkallës D-dur.

Nxënësi/ja në fund të orës do ta këndojë këngën:

- me artikullim të drejtë, duke i respektuar të gjitha indikacionet që janë të shënuara në këngë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Mësimdhënësi/ja u flet nxënësve për festat e fundvitit.
- Kënga fillimisht këndohet me solmizim, duke e ndarë melodinë në pjesë të vogla. Pasi që është mësuar e fragmentarizuar, kënga, në vazhdim, do të këndohet në tërësi. Gjatë këndimit të përsëritur, nxënësit taktojnë.
- Mësimdhënësi/ja duhet të angazhohet që t'i vërejë me kujdes gabimet që nxënësit mund t'i bëjnë gjatë këndimit dhe t'i korrigjojë ato.
- Pasi që janë punuar të gjitha pjesët përbërëse të këngës, kënga këndohet pa u shkëputur.

Erdhi Viti i Ri

K. Kono

Allegro

Ja na er- dhi

Vit'i Ri sa jam i gë - zu - ar por-si u - në - çdo fë - mi

pret për- ta fes - tu - ar *f* Bo-ra zbar-dhi tej- për- tej fu-sha e - dhe

ma - le__ Vit' i Ri_ do të_ na_ gjej me këng e-dhe va - lle

The image shows a musical score for the song 'Viti i Ri'. It consists of a vocal line on a single staff and a piano accompaniment on three staves. The vocal line is in a treble clef with a key signature of one sharp (F#). The lyrics are written below the notes. The piano accompaniment is in a 4/4 time signature and features a steady rhythmic pattern in the right hand and a more active bass line in the left hand.

E Stolisa bredhin tim
me lodra me yje
era jashtë me tërbim
le të fryjë në pyje

Ref:

Plot dhurata përsëri
do të sjellë për mua
vit' i ri, o vit t' i ri
sa fort unë të dua.

Këshillë mësimdhënësit/es

Rrjedha e punës, ashtu si te kënga “We wish you a merry Christmas”, do të jetë e njëjtë. Te kënga “Viti i Ri” nxënësit do të nxiten të shoqërojnë melodinë me instrumentet ritmike, shuplaka apo ndonjë instrument tjetër me goditje.

Tema: Shkalla e-mol dhe kënga: Shqiponja dhe balona

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Krijimtaria dhe performanca artistike; Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Shkalla e-mol, shqiponja dhe balona

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Gjuhë shqipe, histori

Gjuhë dhe komunikim, shoqëria dhe mjedisi

Përforcimi i aftësisë: Këndimi

Elementi në fokus: Melodia, përvetësimi këngës sipas tekstit notal, elementet muzikore

Mjetet e punës: Auditive - CD player, ksilofon

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

- Nxënësi aftësohet që të mësojë këngët përmes tekstit notal.
- Zhvillimi i veshit melodik.

Nxënësi/ja në fund të orës do ta këndojë këngën:

- me emocion të duhur.
- me artikulum të drejtë, duke i respektuar të gjitha indikacionet që janë të shënuara në këngë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Nxënësit e lexojnë (recitojnë) dhe analizojnë vargjet me qëllim që ta kuptojnë drejt përmbajtjen poetike të tekstit.
- Bëhet ligjërimi ritmik i tekstit të këngës dhe përpunohet ritmi i këngës me rrokje neutrale.
- Flitet për simbolikën poetike që shqiponja ka në kulturën dhe traditën shqiptare (shqiponja si pjesë e flamurit kombëtar).

- Në procesin e analizës muzikore të këngës, nxënësit dallojnë dhe evidentojnë tonalitetin e këngës, llojin e masës, parashenjën (fa diez), strukturën ritmike të këngës, karakteristikat e dinamikës.
- Nxënësit këndojnë shkallën e-mol dhe rikujtojnë njohuritë teorike mbi këtë shkallë.
- Kënga fillimisht këndohet me solmizim, duke e ndarë melodinë në pjesë të vogla. Pasi që është mësuar e fragmentarizuar, kënga, në vazhdim, do të këndohet (me solmizimi) në tërësi. Gjatë këndimit të përsëritur, nxënësit taktojnë.
- Arsimtari duhet të angazhohet që t'i vërejë me kujdes gabimet që nxënësit mund t'i bëjnë dhe t'i korigjojë ato.
- Segmentet e këngës që mund të paraqesin vështirësi për nxënësin, arsimtari i përsërit dhe i përforcon në veçanti.
- Pasi që janë punuar të gjitha pjesët përbërëse të këngës, kënga këndohet pa u shkëputur.

Tema: Muzika vokale I, II dhe III

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Muzika dhe shoqëria

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Muzika vokale, sopran, alt, tenor, bas, muzika korale

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Histori

Përforcimi i aftësisë: Dëgjimi

Elementi në fokus: Gjinitë (llojet) muzikore; dallimi mes zërave

Mjetet e punës: Auditive, CD player; vizuale (përmes internetit/kompjuterit, fotografive të interpretëve/solistëve femërorë dhe mashkullorë; fotot apo vizatime të korit të përzier, korit të meshkujve, korit të femrave, korit të fëmijëve; libri

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT


Rezultatet e të nxënit

- Zhvillimi i aftësisë që të dallojnë zërat.
- Zhvillimi i aftësisë të dallojnë ansamble korale.
- Zhvillimi i interesimit për muzikën korale.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Duke e konsideruar muzikën vokale si një fushë shumë të rëndësishme në muzikë, fushë me të cilën nxënësi do të ketë kontakt si dëgjues, por edhe si pjesëmarrës aktivë, është e domosdoshme që t'i ofrohen informacionet bazë lidhur me të.

- Këndimi konsiderohet mënyra më e lashtë e shprehjes dhe muzikimit muzikor. Të gjitha bashkësitë shoqërore, që nga lashtësia, muzikën e kanë pasur si pjesë përbërëse të jetës së tyre. Muzika që këndohet quhet muzikë vokale, për dallim nga muzika instrumentale që luhet në instrumente.
- Muzika vokale mund të shoqërohet edhe me instrumente dhe këtë lloj të muzikës e emërtojmë si **muzika vokalo-instrumentale**.



Ecuria e punës

Mësimdhënësi/ja do t'u shpjegojë nxënësve llojet e zërave dhe dallimet e tyre për nga lartësia, ngjyra dhe intensiteti.

- Zërat femërorë janë: *soprano* – zëri i lartë, *mexosoprano* – zëri i mesëm dhe *alto* – zëri i ulët.
- Zërat mashkullorë janë: *tenori* - zëri i lartë, *baritoni* – zëri i mesëm dhe *basi* – zëri i ulët.

Mësimdhënësi/ja do t'u shpjegojë nxënësve formacionet e ansambleve vokale. P.sh. muzika vokale mund të jetë **solistike**, nëse e këndon një këngëtar, duo, trio, kuartet (në rast se e këndojnë dy, tre apo katër këngëtarë) dhe **korale**, nëse këndohet nga ana e grupit të këngëtarëve (korit).

Derisa këndimi solistik shpreh arritjet artistike të individit, këndimi kolektiv është shprehje e muzikimit kolektiv, nën udhëheqjen e dirigjentit. Këndimin kolektiv e quajmë **këndim koral**, kurse ansamblin e quajmë **kor**.

Nxënësit do të dëgjojnë disa shembuj për të identifikuar dhe dalluar përmes dëgjimit llojet e zërave (të femrave dhe meshkujve).

Shembuj për dëgjim:

Ermonela Jaho (soprano): Aria nga opera “Madama Butterfly”

Luciano Pavarotti (tenor): O sole mio

Muzika vokale I, II

Ecuria e punës

Pasi nxënësit tashmë njohin dhe identifikojnë llojet e zërave të femrave dhe meshkujve, në vazhdim do të njoftohen me ansamblet e mëdha. Në vazhdim Mësimdhënësi/ja do të shpjegojë korin dhe rëndësinë e tij.

Kori është një ansambël vokal, në të cilin këndohen njëkohësisht disa vija melodike të ndryshme, në mënyrë kolektive. Atë e përbëjnë zëra të ndryshëm, që dallojnë për nga lartësia.

Nxënësve do t’u shpjegohet se:

- **korin e përzier** e përbëjnë zërat: *soprano - alto - tenor - bas*, pastaj dallojmë:
- **korin e femrave**, e përbëjnë zërat: *soprano - alto ose soprano- mexosoprano- alto*) dhe
- **korin e meshkujve**, të cilin e përbëjnë zërat: *tenor – bas ose tenor – bariton - bas*.

- **kori i fëmijëve**, zakonisht e formojnë fëmijët (nxënësit) e shkollave fillore. Ky ansambël ndahet në dy zëra (zëri i lartë dhe zëri i mesëm), ose në tre zëra (i larti, i mesmi dhe i ulëti).

- Këndimi në kor është një aktivitet shumë i rëndësishëm që organizohet, zakonisht, në nivel të shkollës, nga nxënësit e talentuar dhe nxënësit që dashurojnë këndimin kolektiv. Konsiderohet një nivel më i lartë i muzikimit kolektiv.

Nxënësit në vazhdim do të dëgjojnë fragmente auditive të korit miks dhe korit të fëmijëve, duke nxitur nxënësit që ta qëllojnë se çfarë kori janë duke dëgjuar.

Shembuj për dëgjim:

Kori i fëmijëve

Kurt Bestor “Prayer of the children”

Këndimi koral është formë themelore në zhvillimin e kulturës muzikore të një mjedisi.

- Kori luan rol të rëndësishëm në socializimin e fëmijës dhe në zhvillimin edukativ të tij.
- Kultivimi i këndimit koral zhvillon veshin muzikor të fëmijës, meqë ai njëkohësisht duhet ta dëgjojë këndimin, këndimin e drejtë dhe të pastër intonativisht dhe përshtatjen në këndim të përbashkët, ndikon në zhvillimin e shijes artistike dhe asaj estetike.
- Këndimi koral e nënkupton **ndërvarësinë**, si një prej komponentëve të rëndësishëm të mësimit bashkëkohor muzikor, për faktin se aktivitetet në kor dhe në orkestra e nxisin nxënësin që ai të punojë dhe të veprojë në mënyrë kolektive.

Mësimdhënësi/ja duhet t'iu shpjegojë nxënësve se nga moshën 12-16 zëri i fëmijës fillon të ndryshojë, sidomos te djemtë. Zëri bëhet më i thellë dhe më i fortë. Ky proces i ndryshimit të ngjyrës së zërit quhet **mutacion** i zërit.

Këshillë mësimdhënësit/es

- Nxitni nxënësit që të diskutojnë, të komentojnë rreth përshtypjeve që kanë për zërat bazë (soprano, alto, tenor, bas).
- Shpjegoni nxënësve lidhur me mutacionin që vjen te fëmijët e moshës 12-16 vjet.
- Dallimi i zërave të korit, duke dëgjuar ndonjë shembull në të cilin janë mirë të diferencuar rolet e sektorëve të ndryshëm të zërave (soprano, alto, tenor, bas).

Pjesa përfundimtare e orës

- Nxënësit nga lista e veprave që i kanë dëgjuar, zgjedhin veprën dhe solistin e tyre të preferuar.

Tema: Solo kënga

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Muzika dhe shoqëria; Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Solokënga "Winterreise", Schubert, elemente muzikore, poezi

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Gjuhë të huaja, histori, literaturë

Përforcimi i aftësisë: Forma muzikore, elemente muzikore

Elementi në fokus: Dëgjim

Mjetet e punës: Auditive, CD player

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

- Njohja e formës muzikore solokënga.
- Njohja e kompozitorëve më të njohur të solokëngës (Shuberti).
- Njohja e kompozitorëve shqiptarë të solokëngës.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve se solokënga është një formë muzikore që bashkon muzikën dhe poezinë. Zakonisht kjo formë shkruhet për zë dhe piano apo për zë dhe orkestër.
- Mësimdhënësi/ja flet për kompozitorët më të njohur të solokëngës, sic janë Hugo Volf, Johanes Brams etj., me ç'rast veçohet Franc Shubert, i cili konsiderohet kompozitori më i famshëm i kësaj forme muzikore. Flet për krijimtarinë e këtij kompozitori gjerman, për krijimtarinë e tij të madhe dhe për zhvillimin e formës së solokëngës në periudhën e romantizmit muzikor, në shekullin XIX.
- Mësimdhënësi/ja u flet për kompozitorët shqiptarë, të cilët kanë kompozuar formën e solokëngës, duke veçuar kompozitorët V. Gjini, Esat Rizvanolli, Feim Ibrahim, Z. Ballata etj.

- Arsimtari/ja u shpjegon nxënësve se muzika klasike shqiptare zhvillohet më tepër në pjesën e dytë të shekullit XX, andaj kompozitorët shqiptarë që kanë kompozuar këtë formë i takojnë pikërisht kësaj periudhe.

Shembuj për dëgjim:

Franc Schubert, 'Winterreise' ('Udhëtimi dimëror')

Vinçenc Gjini, 'Letrat'

Tema: Vendi im

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Krijimtaria dhe performanca artistike; Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Vendi, dinamika

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Gjuhë amtare, shoqëria dhe mjedisi

Përforcimi i aftësisë: Këndimi

Elementi në fokus: Melodia, elementet muzikore / shkrim-leximi muzikor

Mjetet e punës: Auditive - CD, ilustrim

Vendi im

R. Rudi
Q. Guranjaku

Moderato

Sa py - je ma - le, fu - sha me lu - le, kro - je t'ar - gjen - d'ta
ka ven - di im. Bu - rra vi - ga - na, djemt' si pe -
tri - ta, gra, va - sha t'bu - kra ka ven - di im.

f
p

Si zë bilbili,
Porsi val' e detit,
Vjen gjuha shqipe
E vendit tim!

Ku gjinden zanat?
ku gjinden trimat?
ku gjinden nanat?
si n'vending tim.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/ja, në fund të orës do ta:

- njohin konceptin e **dinamikës** në muzikë.
- përshkruajnë qëllimin dhe rëndësinë e dinamikës në muzikë.
- njohin “pp, p, mf, f, ff” në gjuhën e muzikës.
- mund të performojnë melodi apo të këndojnë këngët duke respektuar shenjat e dinamikës.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

Mësimdhënësi/ja do t’u shpjegojë nxënësve definicionin e dinamikës dhe si ajo ndikon në shprehjen dhe karakterin e veprës apo këngës.

Mësimdhënësi/ja do të fillojë se pari duke e punuar tekstin fillimisht dhe pastaj melodinë e këngës. Në vazhdim do të kërkojë nga nxënësit që të respektojnë shenjat e dinamikës, në mënyrë që interpretimi të jetë i saktë.

Ndryshimet e dinamikës



crescendo

Rrite zërin gradualisht!



decrescendo

Ule zërin gradualisht!

Tema: Forma e këngës dypjesore: Kur buzëqesh nëna ime

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Krijimtaria dhe performanca artistike; Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Forma e këngës, dypjesore, nëna

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Shoqëria dhe mjedisi

Përforcimi i aftësisë: Këndimi

Elementi në fokus: Melodia, elementet muzikore / shkrim-leximi muzikor

Mjetet e punës: Auditive - CD, ilustrim, pano, blokflaut

Dëgjimi muzikor në klasat e mëhershme ka pasur për synim parësor zhvillimin e dashurisë ndaj muzikës, duke kultivuar dëgjimin emocional dhe përjetues, ku theksi ka qenë në evidentimin e karakterit dhe atmosferës së veprës muzikore, duke nxitur te nxënësi që ai të formojë imazhe të ndryshme asociative. Në kuadër të kësaj metode të dëgjimit muzikor, sigurisht që është përjetuar edhe forma muzikore, por, në kuadër të saj nuk është analizuar në mënyrë teorike koncepti i formës muzikore.

Tashti, në klasën e gjashtë, dëgjimi muzikor nënkupton një perceptim më komplet të muzikës, meqë nxënësi, përmes dëgjimit duhet të dallojë me precizitet një mori detajesh, në mes tjerash, edhe **formën** e veprës dhe pjesët përbërëse të saj. Për ta arritur këtë, përveç zhvillimit të kulturës së dëgjimit aktiv, nxënësi duhet ta zhvillojë edhe aftësinë e dëgjimit analitik.

Përmes **dëgjimit analitik** nxënësi do të aftësohet të vërejë dallimet dhe **kontrastin** mes pjesëve dhe **përsëritjen** e pjesëve të caktuara.

- *Kontrastin* nxënësi do ta hetojë përmes dallimeve karakteristike në dinamikë, në tekstin e këngës, në ndryshimet melo-ritmik apo në ndonjë detaj tjetër, me çka ai do ta vërejë dhe do ta identifikojë më lehtë pjesën e dytë. Përfundimisht, nxënësi do ta kuptojë se forma e këngës dypjesore ndërtohet mbi parimin e kontrastit.
- Ndërkaq, këngën trepjesore nxënësi do ta dallojë duke evidentuar *kontrastin* mes pjesës së parë dhe pjesës së dytë dhe përsëritjen e pjesës së parë.

Kur buzëqesh nëna

R.Rudi

Vivo

Kur buz' qesh në - na__ i - me sa shum' lu - le çe - lin n'fu-shë Kur këndon

në - na__ i - me ngjan bu - ri - mit me gur - gu - lli - me e di - ni çka ësh të

në - na__ i - me ësh - të drit' e je - tës je - tës__ si - me.

II

Kur punon nëna ime
 është si bleta n'lule, n'fushë
 kur këndon nëna ime
 ngjan burimit me gurgullime

Ref:

E dini çka është..

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënimit

Në fund të orës nxënësit përmes dëgjimit duhet:

- të aftësohen ta dallojnë dypjesoren dhe trepjesoren.
- të njihet me parimet themelore të ndërtimit të formave – *kontrasti* dhe *përsëritja*.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Meqë shumica e këngëve që nxënësit i mësojnë kanë formën dypjesore, në fillim, shpjegimi i dypjesorës mund të bëhet përmes shembujve të këngës, me ç'rast mund të merret si këngë demonstruese njëra prej këngëve që ata më parë e kanë punuar.
- Mësimdhënësi/ja në fillim të orës përpiqet të krijojë një atmosferë të përshtatshme pune, duke kërkuar nga ata që, pasi ta kenë dëgjuar këngën, të shprehin përjetimin e tyre lidhur me të.
- Me qëllim që t'i ndihmojë nxënësit që ata të vërejnë sa më lehtë dallimin mes pjesës së parë dhe asaj të dytë, është mirë që në fund të pjesës së parë arsimtari të bëjë një ngadalësim (ritenuto) apo ulje të dinamikës, e pastaj pjesën e dytë ta fillojë në temp të duhur dhe me një dinamikë më të fortë.
- Është e mundshme që qysh me dëgjimin e parë ndonjë prej nxënësve (më muzikal), të vërejë kontrastin (ndryshimin) në dinamikë, mes dy pjesëve *p* dhe *f*. Gjithashtu, është e pritur që nxënësit t'i vërejnë ndryshimet, në ritëm mes pjesës së parë dhe asaj të dytës (në pjesën e parë dominojnë vlerat e notave katërshe, kurse te pjesa e dytë shfaqen vlerat tetëshe të notave). Nëse nxënësit nuk i vërejnë këto dallime, atëherë arsimtari në mënyrë më konkrete mund të pyesë për dallimin që ata vërejnë në vlerat ritmike, dallimin në dinamikë, dallimin në temp, dallimin në karakterin e tyre etj.
- Pasi që e konstatojnë dallimin (kontrastin) mes pjesës së parë dhe pjesës së dytë, arsimtari kërkon nga nxënësit që t'i emërtojnë se cilat elemente e bëjnë këtë ndryshim (dinamika, melodia, ritmi apo teksti).
- Nxënësit, në fund, mund ta këndojnë këngën, duke u ndarë në dy grupe: pjesën e parë e këndon njëri grup, kurse pjesën e dytë grupi tjetër. Në këtë mënyrë edhe më tepër do të bëhet i qartë për nxënësit kontrasti mes pjesëve.

Këshillë mësimdhënësit/es

Mësimdhënësi/ja duhet ta ketë parasysh se dëgjimi analitik në përcaktimin e formave muzikore (përfshirë edhe formën e këngës), në orët e mëvonshme shtjelohen me metodologji të njëjtë, siç është përdorur më lart.

Tema: Forma e këngës trepjesore të thjeshtë dhe të përbërë: Erë e lehtë

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Krijimtaria dhe performanca artistike; Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Forma e këngës trepjesore, W.A. Mozart

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Shoqëria dhe mjedisi

Përforsimi i aftësisë: Dëgjimi

Elementi në fokus: Elementet muzikore / shkrim-leximi muzikor

Mjetet e punës: Auditive - CD, ilustrim, piano, blokflaut

Erë e lehtë

The image shows three staves of musical notation for the song 'Erë e lehtë'. The first staff is labeled 'a' and contains a melodic line with a treble clef, a key signature of one flat (B-flat), and a 3/4 time signature. The second staff is labeled 'b' and contains a bass line with a treble clef, a key signature of one flat, and a 3/4 time signature. The third staff is labeled 'a' and contains a melodic line with a treble clef, a key signature of one flat, and a 3/4 time signature. The notation includes various note values, rests, and bar lines.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënësve

Në fund të orës, nxënësit përmes dëgjimit duhet:

- të aftësohen ta dallojnë formën e trepjesores.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- **Kënga tripjesore**, siç dihet, përbëhet nga tri pjesë, me ç'rast pjesa e parë dhe e treta janë të njëjta, ndërsa pjesa e dytë kontraston.
- Formën tripjesore arsimtari e demonstroi përmes këngës "Erë e lehtë", me të njëjtën metodologji, me ç'rast fokusi do të jetë në nxitjen e nxënësve që të vërejnë përsëritjen e pjesës së parë (pas pjesës së dytë kontrastuese).
- Arsimtari i nxit *nxënës* që përmes dëgjimit të shembujve instrumentale të identifikojnë dhe të dallojnë formën e këngës dypjesore dhe tripjesore.

Tema: Këngë 'Pranvera dhe masa' 6/8

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Krijimtaria dhe performanca artistike; Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Pranvera, masat, masat e përbëra

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Shoqëria dhe mjedisi

Përforcimi i aftësisë: Këndimi

Elementi në fokus: Melodia, mësimi i këngës me tekst notal

Mjetet e punës: Auditive - CD player

Pranvera

V.A.Mozart

Allegro



Ti, e - ja moj pran - ver, me gë zim e lu - le plot, dhe
shum bu - ri - me zgjon ma - le fu - sha gjel - bë - ron. Dhe
die - lli në mën - gjez kur lind, të gjith - ve do t'na zgjoj, që
pu - nën ta fi - lloj - më, dhe je - tën ta gë - zojm.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit


Nxënësi/ja, në fund të orës, duhet:

- të ketë artikulum të qartë dhe shqiptim të drejtë të tekstit.
- ta intonojë pastër melodinë e këngës.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Në fillim të orës hapet diskutimi lidhur me stinën e pranverës.
- Nxënësit analizojnë vargjet me qëllim që ta kuptojnë drejt përmbajtjen poetike të tekstit.
- Bëhet ligjërimi ritmik i tekstit të këngës dhe përpunohet ritmi i këngës me rrokje neutrale.
- Në procesin e analizës muzikore të këngës, nxënësit përqendrohen në njohjen e masës 6/8, meqenëse tash ajo për herë të parë paraqitet në këngë.
- Nxënësit përkujtojnë masat e thjeshta (2/4, 3/4 dhe 4/4).
- Masa 6/8 konsiderohet masë e përbërë dhe e rregullt ($6/8 = 3/8 + 3/8$).
- Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve se në literaturë e gjejmë zakonisht në temp të shpejtë, me ç'rast masa interpretohet me dy lëvizje.



Arsimtari e luan apo e këndon këngën "**Pranvera**" me shenja të dorës, në mënyrë që nxënësit ta kuptojnë lëvizjen dhe ritmin.

Tema: Muzika popullore

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Muzika dhe shoqëria

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Muzika popullore, muzika klasike, instrumentet popullore ritmike dhe melodike

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Historia, gjeografia

Përforcimi i aftësisë: Dëgjimi

Elementi në fokus: Muzika dhe instrumentet popullore

Mjetet e punës: Auditive - CD player; vizuale (përmes internetit/kompjuterit, fotografive të vallëzimit popullor, veshjes tradicionale); libri

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Në fund të orës nxënësit përmes dëgjimit do t'i dallojnë:

- muzikën popullore.
- llojet e instrumenteve popullore.
- i njohin disa nga veprat e kompozitorëve shqiptarë, të inspiruar nga muzika popullore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Mësimdhënësi/ja u përkujton se muzikën popullore me shekuj e krijoi populli. Është prej atyre llojeve të muzikës, të cilën e kanë krijuar muzikantët e talentuar, por pa ndodnje arsimim të duhur muzikor. Ajo është përcjellë gojarisht.
- Mësimdhënësi/ja do t'u shpjegojë nxënësve se këngët që janë krijuar, shpeshherë, nuk u dihet autorësia, por populli i pranon dhe i përvetëson si të vetat. Së këndejmi, këngën e njëjtë e gjejmë të kënduar në variante të ndryshme, varësisht nga regjioni dhe nga interpretuesi.

- Mësimdhënësi/ja e thekson se muzika jonë popullore është njëra prej traditave popullore më të ruajtura. Ajo është e pasur dhe e larmishme, kështu që çdo krahinë shqiptare ka muzikë me veçori të veta.
- Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve se shpeshherë kënga popullore ka qenë frymëzim për shumë kompozitorë shqiptarë të muzikës klasike. Kënga jonë popullore “Oj Lulija jonë” e ka frymëzuar kompozitorin R. Rudi që në sonatën për violinë ta përpunojë pikërisht këtë këngë. Shembuj të shumtë do të gjejmë edhe në muzikën e kompozitorëve të njohur botërorë, si Bela Bartok, Igor Stravinski etj.

Shembuj për dëgjim:

Bela Bartok: Valle Rumune dhe

Rafet Rudi: Fragment nga sonata për violinë e piano

Instrumentet popullore ritmike dhe melodike

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Muzika dhe shoqëria

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Muzika popullore, muzika klasike, instrumentet popullore, ritmike, melodike

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Historia, gjeografia

Përforcimi i aftësisë: Dëgjimi

Elementi në fokus: Muzika dhe instrumentet popullore

Mjetet e punës: Auditive - CD ; vizuale (përmes internetit/kompjuterit, fotografive të vallëzimit popullor, veshjes tradicionale); libri

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Në fund të orës, nxënësit përmes dëgjimit do të:

- dallojnë llojet e instrumenteve popullore.
- njohin orkestrën popullore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Arsimtari/ja ua përkujton nxënësve se çdo muzikë popullore ka edhe instrumentet e veta karakteristike. Në muzikën tonë popullore dallojmë një numër të madh instrumentesh **ritmike** si dhe ato **melodike**. Megjithatë, disa prej tyre veçohen për nga tingulli karakteristik, përmes të cilëve identifikohet muzika jonë.
- Arsimtari/ja kërkon nga nxënësit që të kujtohen se cilat instrumente popullore ritmike i kanë mësuar deri më tash.
- Arsimtari/ja veçon **tupanin**, duke e theksuar faktin se tupani është një ndër instrumentet më të lashta të muzikës, **defin** gjithashtu arsimtari/ja u shpjegon nxënësve se **lodra e vogël** ngjason në instrumentin e tupanit.
- Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të shprehin se çfarë dallimi ka mes instrumenteve ritmike nga atyre melodike.
- Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të flasin për instrumentet popullore melodike që ata i njohin.

- Arsimtari/ja dallon instrumentet melodike popullore, me të cilat karakterizohet, në masë të madhe, muzika jonë popullore. Dallon çiftelinë, sharkinë dhe lahutën.

Në orkestrat popullore, pos instrumenteve karakteristike dhe të vjetra, si çiftelia, sharkia, fyelli, lahuta, kavalli etj., në përbërjen e tyre paraqiten edhe një mori instrumentesh të importuara nga jashtë. Ndër ato më së shpeshti i gjejmë violinën, fizarmonikën dhe klarinetin. **Violina** në trevat tona paraqitet në shekullin XIX në përbërje të instrumentistëve popullorë Përdoret më tepër në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut, si dhe në Kosovë.

Klarinetin e gjejmë te shqiptarët së pari në Shkodër, në mesin e shekullit XIX, në kuadër të orkestrinave të ahengut. Klarineti trajtohet si instrument kryesor melodik.

Shembuj për dëgjim:

- Potpuri vallesh në interpretim të **orkestrës popullore** të Radio Televizionit të Prishtinës.
- **Nexhmije Pagarusha** në interpretim të këngës “Mora testinë”.

Tema: Muzika instrumentale

Formacionet kamertale, orkestra harkore

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Muzika dhe shoqëria

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Orkestra harkore, orkestra frymore, kuinteti frymor, violina, klarineti, flauti

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Historia, gjeografia, arti figurativ, gjuha amtare, letërsia, arkitektura

Përforcimi i aftësisë: Dëgjimi

Elementi në fokus: Instrumentet dhe formacionet muzikore

Mjetet e punës: Auditive - CD ; vizuale (përmes internetit/kompjuterit, fotografive të instrumenteve/solistëve. Fotot e qytetit të Prizrenit me shtëpi të arkitekturës orientale; vendosja e disa fotove demonstruese, në të cilat shihen qartë instrumentet që ata i dëgjojnë; video nga koncerti i orkestrës simfonike dhe orkestrës harkore; libri

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

- Zhvillimi i aftësisë që të dallojnë instrumentet dhe orkestrat.
- Zhvillimi i aftësisë të dallojnë ansamble kamertale dhe orkestrale.
- Zhvillimi i interesimit për muzikën orkestrale.
- Zhvillimi i ndjenjës për dëgjim muzikor.


Në fund të orës, nxënësit përmes dëgjimit do të:

- dallojnë llojet e orkestrave.
- dallojnë llojet e instrumenteve të ndryshme (kornën, flautin, harpën, pianon, timpanin) etj.
- njohin disa nga veprat e kompozitorëve shqiptarë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

- Gjatë procesit mësimor, qysh nga klasat e nivelit më të ulët, nxënësi ka filluar ta njohë muzikën instrumentale, para së gjithash ka njohur instrumentet ritmike (instrumentet popullore ritmike, instrumentet të ndërtuara nga vetë ai, apo instrumentet e ORF-it), por edhe disa instrumente melodike. Luajtja e instrumenteve ritmike ka qenë kryesisht në funksion të shoqërimit instrumental të këngëve.

- Në klasën VI, nxënësit njihen me instrumentet përfaqësuese të grupeve instrumentale, harkore, frymore dhe atyre me goditje (harpa, piano, korna, timpani etj.). Kjo e aftëson nxënësin që të përjetojë veprat në mënyrë më të plotë dhe në tërë bukurinë e saj. Gjithashtu, njohja e instrumenteve dhe njohja e muzikës instrumentale, pa mëdyshje, zhvillon dashurinë për muzikën dhe rrit mundësinë që nxënësi t'i përkushtohet ndonjë instrumenti.
- Nxënësit duhet shpjeguar dallimin e muzikës instrumentale nga muzika vokale, duke përcaktuar qartë se muzika instrumentale është ai lloj i muzikës që u destinohet instrumenteve (instrumenteve solistikë, formacioneve kamertale dhe orkestrave), për dallim nga muzika vokale që i destinohet zërit.
- Nëse shkolla ka kabinetin e muzikës, është e domosdoshme që brenda mureve të saj të qëndrojnë instrumentet, fotografitë dhe vizatimet e instrumenteve si dhe të orkestrave. Kjo do të mundësonte mësimin më efikas dhe më kuptimplotë të tyre.



Ecuria e punës

Formacionet kamertale

Arsimtari u shpjegon nxënësve se ekzistojnë formacionet kamertale të përbëra prej instrumenteve të të njëjtit grup instrumental.

- **Kuarteti harkor** - përbëhet prej 2 *violinave*, *violës* dhe *violonçelit*.
- **Trio harkore** - përbëhet prej *violinës*, *violës* dhe *violonçelit*.
- **Kunteti frymor** - përbëhet prej instrumenteve frymore: *flautit*, *oboas*, *klarinetit*, *fagotit* dhe *bririt*.
- **Trio pianistike** – përbëhet prej *violinës*, *violonçelit* dhe *pianos*.

Nxënësit do të dëgjojnë veprën:

“Kunteti frymor” të Fahri Beqirit (koha e parë)

(Orkestra harkore)

Ecuria e punës

Pasi t’i kenë kuptuar nxënësit formacionet kamertale, arsimtari/ja do të vazhdojë shpjegimin lidhur me orkestrën harkore, duke treguar se atë e përbëjnë instrumentet me harqe:

- violinat e para,
- violinat e dyta,
- violat,
- violonçelot,
- kontrabasët.

(Ndonëse numri i përgjithshëm ndryshon, zakonisht ky lloj i orkestrës numëron rreth 20-30 instrumentistë.)

Nxënësit do të dëgjojnë veprën:

“Akuarelet e Prizrenit” (kohën e parë), për orkestër harkore të kompozitorit Rexho Mulliqi.

Këshillë mësimdhënësit/es

Nxitni nxënësit që:

- të shprehin përshtypjet që kanë lidhur me veprën e dëgjuar.
- në bazë të dëgjimit, t’i shprehin përmes vizatimit përshtypjet që ata i kanë fituar, apo përjetimin dhe emocionet e tyre t’i shprehin me një përshkrim poetik në prozë apo në poezi.

- të flasin për Prizrenin, për arkitekturën e këtij qyteti dhe për stilin e shtëpive në Prizren.
- të përkujtojnë ndonjë ngjarje historike që lidhet me këtë vend (p.sh., Lidhja e Prizrenit).
- të flitet për kompozitorin Rexho Mulliqi dhe të përkujtojnë ndonjë vepër tjetër të këtij kompozitori, nëse kanë dëgjuar.

(Orkestra simfonike)

Ecuria e punës

Arsimtari/ja do t'u flasë nxënësve për orkestra simfonike, këtë formacion më të kompletuar orkestral. Ai/ajo do t'u shpjegojë nxënësve që orkestra simfonike përfshin në vete të gjitha grupet instrumentale, duke cekur se orkestrën simfonike e përbëjnë:

- Grupi i instrumenteve frymore të drunjta (flauti, oboa, klarineti, fagoti),
- Grupi i instrumenteve frymore të tunxhit (briri, tromba, tromboni etj.)

- Grupi i instrumenteve me goditje dhe
- Grupi i instrumenteve harkore.

Në fund të orës:

- Nxënësit do të përkujtojnë dhe do të përshkruajnë orkestrat që i kanë dëgjuar deri më tash, apo ato orkestrat që i kanë parë në koncerte.
- Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të tregojnë se cili është dallimi kryesor mes korit dhe orkestrës si dhe të bëjë dallimin mes muzikës vokale dhe asaj instrumentale.
- Të nxiten nxënësit që të flasin për muzikën artistike shqiptare; të tregojnë se cilët prej kompozitorëve shqiptarë ata i njohin dhe se cilat vepra të kompozitorëve tanë ata i kanë dëgjuar apo me të cilat janë njohur në çfarëdo mënyre.

Vlerësimi

Mësimdhënësi/ja vlerëson nxënësit:

- për angazhimin në diskutimet lidhur me veprat e dëgjuara.
- për shprehjen e kreativitetit në vendosjen e paraleleve me tema të tjera kurrikulare.
- për efikasitetin e përgjigjeve në dallimin e instrumenteve dhe orkestrave.
- për përgjigjet lidhur me njësitë mësimore të mëparshme (temat e instrumenteve të punuara në orët e mëparshme).

Tema: Triola dhe kanoni

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Triola, kanoni

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Matematikë

Elementi në fokus: Shkrim-leximi muzikor

Mjetet e punës: Ilustrim

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi në fund të orës:

- njihet me simbolet, me shenja të ndryshme muzikore.
- njihet me kanonin, triolën.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Mësimdhënësi/ja shpjegon formën e kanonit, duke treguar se kanoni është një lloj kompozimi që performohet në dy apo më shumë zëra. Kanoni është përsëritje (imitim) i melodisë së njëjtë dhe ai ndërtohet në bazë të një rregulli të caktuar nga një zë në tjetrin.
- Analizojnë bashkërisht shembujt muzikorë në libër.

Kanon



Zëri i parë



Zëri i dytë



Zëri i tretë



Kanon

Gjini - Kaçinari



(Triola)

Në vazhdim arsimtari/ja do t'u shpjegojë nxënësve se triola është figurë ritmike, në të cilën njësinë e numërimit në vend se ta ndajmë në dy pjesë apo në katër pjesë, e ndajmë në tri pjesë të barabarta.

Tri no - ta të nej - ta for - moj - në tri - o - lën

Row, row, row your boat

E. O. Lyte

Row, row row your boat Gent - tly down the stream

Mer ri - ly mer - ri - ly mer - ri - ly merr - i - ly Life is but a dream'

Tema: Zhanret muzikore

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Muzika dhe shoqëria

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Muzika klasike, muzika zbavitëse, muzika xhaz, muzika rok, muzika popullore

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Gjeografi, histori, shoqëri dhe mjedisi

Përforcimi i aftësisë: Dëgjimi

Elementi në fokus: Zhanret muzikore

Mjetet e punës: Auditive, CD player; vizuale, përmes internetit/kompjuterit, fotografive apo vizatimeve që përmbajnë pamjet karakteristike të performuesit, si orkestrës, vallëzimit karakteristik, veshjes karakteristike të performuesve etj.); libri

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

- Aftësimi në dallimin e zhanreve përmes dëgjimit muzikor.
- Zhvillimi i ndjenjës për dëgjim muzikor.
- Zhvillimi i muzikalitetit dhe zhvillimi i përgjithshëm i kulturës muzikore.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

Në fillimin e orës, arsimtari do të freskojë njohuritë e nxënësve lidhur me zhanret muzikore (në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve).

- Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që në mënyrë teorike t'i evidentojnë dallimet mes zhanreve.
- Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të flasin për instrumentet karakteristike që secili zhanër posedon.
- Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që ata t'i identifikojnë vizualisht grupet instrumentale përkatëse për secilin zhanër.

- Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që përmes dëgjimit të dallojnë zhanret muzikore, duke evidentuar dhe përshkruar dallimet.

Lidhja me fushat e tjera

- Me **gjeografinë** dhe **njohuri shoqërie**, meqë xhazi, e sidomos drejtimi i Blues-it, lidhet me SHBA-në, dhe me shtypjen e zezakëve në fillim të shekullit XX; me lëndën e **historisë** (ngjarjet historike mund të jenë temë në këngët tona popullore).

Pjesa përfundimtare e orës

- Mësimdhënësi/ja i i nxit nxënësit që të luajnë ndonjë temë apo fragment karakteristik të ndonjë prej zhanreve.

Tema: Këngë e cicërime dhe shkalla D-dur

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Krijimtaria dhe performanca artistike; Gjuha dhe komunikimi artistik

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Shkalla D-dur, këngë e cicërime, mësimi i këngës me tekst notal

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Gjuhë dhe komunikim, shoqëria dhe mjedisi

Përforcimi i aftësisë: Këndimi

Elementi në fokus: Melodia, lexim notal, shkrim dhe lexim muzikor

Mjetet e punës: Auditive - CD

Këngë e cicërime

F.Seli

Gëzueshëm



N'fu- shën e blë - ru - ar ku - llot ba - gë - ti - a lu - ajn he - dhin

va - lle - zogj - të dhe - fë - mi - ja. Sa e - bu - kur kën - nga

o sa - mir' kën - don këng'e - ci - cë - ri - me fu - shës po je - hon.

Sa e - bu - kur kën - nga o sa - mir' kën - don

këng e - ci - cë - ri - me fu - shës po je - hon.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

- Nxënësi aftësohet që të mësojë këngët përmes tekstit notal.
- Zgjerimi i njohurive teorike (shkallët mol, diezi etj.).
- Zhvillimi i veshit melodik.
- Njohja e shkallës D-dur.

Nxënësi/ja në fund të orës do ta këndojë këngën:

- me artikullim të drejtë, duke i respektuar të gjitha indikacionet që janë të shënuara në këngë.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Nxënësit e lexojnë dhe i analizojnë vargjet, me qëllim që ta kuptojnë drejt përmbajtjen poetike të tekstit.
- Bëhet ligjërimi ritmik i tekstit të këngës dhe përpunohet ritmi i këngës me rrokje neutrale.
- Në procesin e analizës muzikore të këngës, nxënësit dallojnë dhe evidentojnë tonalitetin e këngës, llojin e masës, strukturën ritmike të këngës, karakteristikat e dinamikës.
- Nxënësit këndojnë shkallën D-dur dhe shenjat.
- Arsimtari duhet të angazhohet që t'i vërejë me kujdes gabimet që nxënësit mund t'i bëjnë dhe t'i korrigjojë ato.
- Segmentet e këngës që mund të paraqesin vështirësi për nxënësin, arsimtari i përsërit dhe i përforcon në veçanti.
- Pasi që janë punuar të gjitha pjesët përbërëse të këngës, kënga këndohet pa u shkëputur.

Tema: Kënga 'Vera'

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Krijimtaria dhe performanca artistike

Lënda: Muzikë

Klasa: 6

Fjalët kyçe: Stina e verës

Çështjet e ndërlidhura (korrelacioni): Gjuhë dhe komunikim, shoqëria dhe mjedisi

Përforcimi i aftësisë: Këndimi

Elementi në fokus: Melodia

Mjetet e punës: Auditive - CD player

Vera

S. Spahiu
C. M. Weber

f Hej haj hoj Kjo ve - rë na gë - zoj *p* në ko - shte me gjel - brim lu - ajm'
me lu - le t'ku - qe t'ba - rdha plot
me lu - le t'ku - qe t've - rdha a -

7
mf lo - jën çdo a - gim o po, po, po, ne lu - ajm' va - llën o
e - rë në - për a - ra
ro - më plot ka ve - ra

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/ja, në fund të orës, duhet:

- të ketë artikullim të qartë dhe shqiptim të drejtë të tekstit.
- intonim të pastër.
- ta këndojë këngën me emocion të duhur.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË ORËS MËSIMORE

Ecuria e punës

- Nxënësit e lexojnë dhe i analizojnë vargjet, me qëllim që ta kuptojnë drejt përmbajtjen poetike të tekstit.
- Bëhet ligjërimi ritmik i tekstit të këngës dhe përpunohet ritmi i këngës me rrokje.
- Flitet për stinën e verës dhe pushimet, për fundin e shkollës.
- Në procesin e analizës muzikore të këngës, nxënësit dallojnë dhe evidentojnë tonalitetin e këngës, llojin e masës, strukturën ritmike të këngës, karakteristikat e dinamikës.
- Kënga fillimisht këndohet me solemnizim, duke e ndarë melodinë në pjesë të vogla. Pasi që është mësuar e fragmentarizuar, kënga në vazhdim do të këndohet (me solemnizëm) në tërësi. Gjatë këndimit të përsëritur, nxënësit taktojnë.
- Pasi që janë punuar të gjitha pjesët përbërëse të këngës, kënga këndohet pa u shkëputur.

Këshilla praktike për mësimdhënësin/en

Ritmi

Veprimet, të cilat e bëjnë të kuptueshëm ritmin dhe rolin e tij në këngë:

- Nxiten nxënësit që ta shënojnë në fletoret e veta vetëm ritmin e këngës ("Zilja po na fton"), me vlera të sakta ritmike që janë në këngë, d.m.th., ndahet ritmi nga melodia, me çka nxënësi e evidenton strukturën ritmike të këngës dhe e dallon ritmin si element i veçantë.

Zilja po na fton

Tring e tring e tring zi - lja po na th'rrer. lam - tu - mir pu - shi - me

shko - lla po na pret pret Me lu - le n'cu - ar m'su - sen e rre -

thojn'. të gjithë të gë - zu - ar kla - sën po shi - kojn'. Tring e tring e

tring zi - lja po na th'rrer. lam - tu - mir pu - shi - me shko - lla po na pret

Melodia

- Si rrjedhë e qartësisimit dhe përvetësisimit të konceptit *ritëm*, Mësimdhënësi/ja do ta ketë më lehtë ta shpjegojë edhe **melodinë**, e cila ka të bëjë me lartësinë e tingujve, por që pashmangshëm lidhet me ritmin.

- Mësimdhënësi/ja duhet t'u shpjegojë nxënësve se **melodia** përbëhet prej një vargu tingujsh që mes tyre dallohen, para së gjithash, për nga *lartësia* e tyre dhe për nga *gjatësia*.

(

- Arsimtari duhet t'u demonstrojë nxënësve me këndimi apo me luajtje në instrument këto dy karakteristikat kryesore të melodisë - *lartësinë* dhe *gjatësinë* e tingullit.
- Arsimtari u sqaron nxënësve se me bashkimin e ritmit dhe melodisë, ne mund të shprehim më së miri mendimet tona muzikore.

Harmonia

- Arsimtari, pa hyrë në shpjegime të thella teorike, u shpjegon nxënësve se harmonia është tingëllima e njëkohshme e dy e më shumë tingujve.
- Arsimtari fillimisht e luan në instrument një melodi. Pastaj melodinë e njëjtë e luan me përcjellje harmonike, duke lënë që vetë nxënësit ta gjykojnë rolin e harmonisë. Ata do ta vërejnë, pa mëdyshje, se ajo tingëllon më plot dhe më bukur.
- Ndonëse melodia mund të ekzistojë pa harmoninë, nxënësit duhet ta kuptojnë se harmonia e pasuron muzikën, duke i dhënë asaj ndjenjën e thellësisë.

Zilja po na fton

Melodia

Harmonia

Grupi i adhuruesve të muzikës**Kreativiteti**

Angazhimi në aktivitete në nivel të shkollës (në kor, orkestër apo ndonjë formë të grupit të adhuruesve të muzikës) do të bëjë që nxënësi t'i shfrytëzojë mësimet teorike, të cilat i ka përvetësuar gjatë vitit dhe të bëjë lidhjen e natyrshme me punën praktike që është duke ushtruar (qoftë në kor, në orkestër apo në ndonjë aktivitet tjetër). Përmes këtyre angazhimeve, pa mëdyshje, do të vazhdojë zhvillimi i kreativitetit të nxënësit, që është

gjithmonë synim parësor në arsimimin dhe edukimin muzikor. Përgjithësisht, arsimtari duhet të gjejë forma dhe rrethana të reja që të ngjallë talentin te nxënësit dhe të nxisë sa më shumë fantazinë e tyre. Gjithsesi, aktivitetet në nivel të shkollës dhe në komunitet, në gara shkollore të qytetit, në manifestime dhe festivale të ndryshme, janë forma që duhen ndjekur.

Vlerësimi përmbledhës në procesin e dëgjimit muzikor

Dëgjimi muzikor

Duke qenë se nxënësit gjatë vitit mësimor fitojnë përvojë në dëgjimin aktiv, por edhe dëgjim analitik muzikor, arsimtari i nxit nxënësit që gjatë dëgjimit muzikor të provojnë të identifikojnë dhe të emërtojnë veprat e dëgjua gjatë vitit.

Me qëllim që dëgjimi muzikor të ngjallë një interes më të madh te nxënësi, arsimtari do të nxisë nxënësit që përmes dëgjimit, ata të identifikojnë zhanret, formën muzikore, llojet e zërave, llojet e orkestrave etj. D.m.th., ata e vrojtojnë veprën muzikore në mënyrë të gjithanshme, që nënkupton se vlerësimin e veprës e bëjnë duke mos qenë të shtrënguar të vlerësojnë, të komentojnë apo të debatojnë për një aspekt të saj. Nxënësi vlerëson në mënyrë të lirë veprën e dëgjuar.

- Bën lidhje në mes formave të muzikës me veprën e dëgjuar.
- Identifikon instrumentet (të cilat i ka punuar gjatë vitit) me veprën e dëgjuar.
- Bën vështrim kritik lidhur me veprën e dëgjuar.
- Identifikon formacionin orkestral.
- Hulumton informacione të ndryshme në internet lidhur me autorin e veprës së dëgjuar.

Të përcjellim koncertin, të debatojmë

Aktivitetet e nxënësve nuk përfundojnë në mësimin e zakonshëm në klasa. Iniciativa për zhvillimin e aktiviteteve jashtë klasës janë të mirëseardhura, ndaj arsimtari duhet t'i ketë parasysh këto. Ai do të frymëzojë nxënësit për iniciativa të reja.

- Arsimtari do të përkrahë dhe do t'i udhëzojë nxënësit që shprehin interesim të zgjeruar ndaj muzikës deri në formimin e rrethit të "dashamirëve të muzikës", që do të funksiononte si një lloj "klubi muzikor".
- Arsimtari është i thirrur t'i përkrahë nxënësit që të shprehin në mënyrë të lirë prirjet e tyre, gjithashtu do të jetë përkrahës i idesë që grupi i dashamirëve të muzikës t'i përcjellë në mënyrë të organizuar, koncertet të muzikës klasike në qytet.
- Arsimtari mund t'i nxisë nxënësit që ata të shprehin përshtypjet e tyre lidhur me koncertin e dëgjuar, duke komentuar krijimet dhe performimet që ata i kanë dëgjuar (lidhur me veprat, autorët, formacionet që i kanë dëgjuar, llojin e muzikës që kanë dëgjuar etj.). Ai do t'i korrigjojë në mënyrë diskrete.
- Zhvillohet edhe debati i hapur në mesin e nxënësve lidhur me temat e shtruar, gjithmonë duke u kujdesur që komentet dhe debatet të bëhet në pajtim me njohjet

teorike që ata kanë fituar gjatë mësimit dhe në pajtim me këto njohuri të përdorin terminologjinë dhe konceptet adekuate.

Puna në grup

Vetiniativa - Ndërvarësia

Arsimtari inkurajon nxënësit që të realizojnë ndonjë projekt të përbashkët mbi një temë të caktuar, e cila potencialisht mundëson gërshetimin e disa lëndëve mësimore si dhe aplikon ndërvarësinë e disa temave ndërkurrikulare (historia, gjeografia, tradita popullore, arti i filmit). Temën nxënësit mund ta propozojnë vetë. Të propozohet nga nxënësit, temë e tillë mund të jetë kënga “Qenkan mbushur malet me borë”.

Projekt ndërkurrikular

Tema: Kënga popullore: “Qenkan mbushur malet me borë”

Qëllimi përfundimtar i projektit

- Zhvillimi i vetiniativës të nxënësi.
- Zgjerimi i njohurive në mënyrë të pavarur (pa ndihmën e arsimtarit).
- Aftësimi i nxënësit që të punojë në grup, duke afirmuar punën kolektive.
- Zhvillimi i aftësisë të përdorimit të teknologjive të ndryshme në funksion të kërkimit të të dhënave të nevojshme.

Veprimet përgatitëse për realizimin e projektit

- Nxënësit përcaktohen për temën e projektit që do ta hulumtojnë (në këtë rast: kënga “Qenkan mbushur malet me borë”).
- Analizohen fushat në të cilat do të zhvillohet hulumtimi, me ç’rast çdo nxënës në grupin prej tre vetave merr një detyrë të përcaktuar.

Veprimet përgatitëse për realizimin e projektit

Me ndihmën e arsimtarit përcaktohen fushat e hulumtimit. Në rastin konkret, tema mund të hulumtohet në tri fusha:

1. Hulumtimi i prejardhjes regjionale/gjeografike të këngës “Qenkan mbushur malet me borë”.
2. Kënga “Qenkan mbushur malet me borë”, si temë në muzikën instrumentale.
3. Kënga “Qenkan mbushur malet me borë”, si temë muzikore në film.

Veprimet për realizimin e projektit

- Hulumtohen dhe identifikohen karakteristikat kryesore të muzikës sonë popullore.
- Mblidhen dhe analizohen shembujt karakteristikë të këngëve popullore sipas krahinave.
- Ndriçohet fakti se në cilat vepra të autorëve shqiptarë kënga “Qenkan mbushur malet me borë” është përdorur si temë bosht. Në këtë rast, përmenden veprat e

kompozitorëve Çesk Zadeja (Simfonia Nr. 1) dhe vepra poema dramatike “Skënderbeu” e Fahri Beqirit.

- Mblidhen informacionet mbi jetën e kompozitorëve Çesk Zadeja dhe Fahri Beqiri nga interneti apo nga librat enciklopedikë.
- Ndriçohet fakti se kënga e njëjtë (“Qenkan mbushur malet me borë”) është përdorur si temë bazë për filmin “Skënderbeu”.
- Të gjitha informacionet e mbledhura analizohen dhe sistemohen sipas fushave të përcaktuara.
- Çdo nxënës ngarkohet me një pjesë të detyrave (apo me një fushë), para se përfundimisht nxënësit ta kompletojnë projektin në një punim të vetëm.

Prezentimi i projektit në Power Point

- Nxënësit prezantojnë projektin dhe hulumtimet që ata kanë bërë për tri fushat e kërkimeve veç e veç.

Fusha e parë e hulumtimit:

- Ekspozon hulumtimet që ka bërë në fushën e muzikës popullore, duke i shoqëruar shpjegimet e veta me shembuj ilustrues.
- Flet për veçoritë e këngëve të të tri krahinave (Kënga e Veriut, Kënga e Shqipërisë së Mesme dhe Kënga e Jugut), duke i shoqëruar ato me ilustrime auditive.
- Numëron disa qytete kryesore të çdo krahine.
- Flet për karakteristikat e veshjeve të të tri krahinave tona, duke ilustruar me foto.

Fusha e dytë e hulumtimit:

- Flitet për veprën Simfonia Nr. 1. e kompozitorit Çesk Zadeja /viti i kompozimit, lloji i orkestrës për të cilën është shkruar.
- Flitet për opusin e përgjithshëm dhe të kompozitorit Ç. Zadeja dhe për veprat e dalluara të kompozitorit.

Fusha e tretë e hulumtimit:

- Flitet për filmin “Skënderbeu”, ku temë kryesore e tij është kënga “Qenkan mbushur malet me borë”.
- Flitet për personalitetin dhe trimërinë e kryetrimit tonë, Skënderbeut.

Forma e punës:

- Grupore, individuale.

Mjetet mësimore të punës:

- Libri, CD-ja, ksilofon, interneti

Lidhja me lëndë të tjera:

- Lidhja me historinë, gjeografinë
- Lidhja me temat ndërkurrikulare: tradita popullore, arti i filmit.

Përmbajtja:

Hyrje në botën e muzikës.....	4
Himni kombëtar	11
Zilja po na fton	13
Fillet e muzikës në trevat shqiptare	15
Si të luajmë në blokflaut?	16
Muzika klasike në Kosovë	18
Të përkujtojmë dhe të mësojmë masat	20
Valsi dhe marshi	21
Temë me variacione	22
Kori gazmor dhe shkalla G-dur	24
Vjeshta / prima sekonda volta	27
Oda e gëzimit	28
Libri i historisë / kompozitorët shqiptarë	30
Instrumentet muzikore I, II dhe III	32
Muzika dhe artet e tjera / Dëgjim: Antonio Vivaldi.....	35
Sinkopa, tempi, korona	37
We wish you a Merry Christmas dhe Erdhi Viti i Ri	39
Shkalla e-mol dhe kënga: Shqiponja dhe balona	43
Muzika vokale I, II dhe III	44
Solo kënga	49
Vendi im	51
Forma e këngës dypjesore: Kur buzëqesh nëna ime	53
Forma e këngës trepjesore të thjeshtë dhe të përbërë: Erë e lehtë	56
Këngë 'Pranvera dhe masa' 6/8	58
Muzika popullore	60
Muzika instrumentale	64
Triola dhe kanoni	68
Zhanret muzikore	71
Këngë e cicërime dhe shkalla D-dur	73
Kënga 'Vera'	75

